



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 248 Akti

Nr. 245 Vendimi
Tiranë, më 5.3.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Maria Tuma, në datën 3.3.2020, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ardit Mustafaj**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).

3. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 18.1.2019, të trupit gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues, komisionere Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

4. Në datën 23.01.2019, subjekti i rivlerësimit deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 12.2.2020, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj, për të tria kriteret e rivlerësimit: kriterin e pasurisë, kriterin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e tij brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në datën 13.2.2020 subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit dhe në datën 23.2.2020 dërgoi prapësimet në mënyrë elektronike dhe njëkohësisht paraqiti kërkesën me objekt “marrjen e disa provave shkresore në funksion të procesit të hetimit administrativ, si dhe pyetjen e shtetasve D. B., Dh. L., P. G., S. H., G. M., S. Z. dhe I. T., me cilësinë e dëshmitarëve”.

7. Trupi gjykues, me vendimin e ndërmjetëm datë 26.2.2020, bazuar në germat “a” dhe “d”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, vendosi të administrojë, me cilësinë e provës, dokumentacionin e depozituar në mënyrë elektronike (në numër rendor 1 - 39) nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të refuzojë kërkesën e tij për thirrjen e dëshmitarëve. Komisioni, në datën 27.2.2020 i njoftoi subjektin të rivlerësimit, në mënyrë elektronike dhe zyrtare, vendimin e ndërmjetëm të arsyetuar.

8. Në datën 26.2.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 3.3.2020, në orën 9:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Maria Tuma. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 3.3.2020, për të rifilluar në datën 5.3.2020, për shpalljen e vendimit. Po në datën 3 mars, subjekti dërgoi në formë elektronike shpjegimet e tij të lexuara në seancën dëgjimore.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Z. Ardit Mustafaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

MBI KRITERIN E PASURISË

Në lidhje me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit sipas deklaratës “Vetting”, nga hetimi ka rezultuar, si vijon:

1. Në lidhje me apartamentin e banimit me sip. 126 m², me adresë: Blv. “****”, p. ***, Tiranë, përfituar me kontratë sipërmarrjeje noteriale nr. ***, datë 28.7.2004, dhe kontratë shitje noteriale nr. ***, datë 10.12.2007, në vlerën 58.369 euro. Pasuri e zotëruar në bashkëpronësi me bashkëshorten.

Burimi i deklaruar i krijimit:

- a. kredi nga BKT-ja (e shlyer plotësisht);
- b. kredi nga “Raiffeisen Bank”;
- c. të ardhura familjare nga puna;
- d. të ardhura nga qiraja;
- e. shitje pasurie sipas kontratës nr. ***, datë 28.3.2004;
- f. hua (e kthyer plotësisht);
- g. të ardhura nga kurset e bashkëshortes;
- h. dhuratë nga të afërmit e bashkëshortes.

Për këtë pasuri subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹.

1.1 ILDKPKI-ja², në raportin e saj, është shprehur: “*Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Sarandë, si dhe për të ardhurat nga kurset e bashkëshortes. Subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit me sip. 126 m² edhe kredi të marrë në ‘Raiffeisen Bank’, me vlerë 5.000.000 lekë, e cila sipas kontratës së kredisë ka qenë me qëllim për strehim, por referuar deklaratës së interesave private periodike vjetore 2006, kjo kredi është përdorur për shlyerjen e detyrimeve ndaj kredisë në BKT dhe ndaj huthënësve, A. M. dhe Gj. D., duke mbyllur tërësisht detyrimet me ta”.*

Faktet e konstatuara nga hetimi administrativ i Komisionit

1.2 Komisionit, nga hetimi administrativ, i ka rezultuar se subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, me përshkrimin “lidhur kontratë sipërmarrjeje për ndërtim apartamenti me firmën “****” sh.p.k., kontratë me nr. ***, datë 28.7.2004. Vlera totale e apartamentit që ndërtohet në Tiranë është 56.700 euro (pagesa me këste). Paguar në vitin 2004, shuma 36.680 euro, e konvertuar në 4.502.000 lekë.”

1.2.i Ndërsa, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 subjekti ka deklaruar: “*Në lidhje me kontratën e sipërmarrjes të datës 28.7.2004 për ndërtim apartamenti në Tiranë është paguar gjatë vitit 2005 kësti i tretë prej 14.350 euro, si dhe 2.522 euro shtesë për pllakat”.*

1.2.ii Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 subjekti ka deklaruar: “*Në lidhje me kontratën e sipërmarrjes të datës 28.7.2004, për ndërtim apartamenti në Tiranë është paguar*

¹ Kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 10.12.2007; vërtetim hipotekor nr. ***, datë 27.12.2007, për apartamentin me sip. 126 m², Rr. “****”, Tiranë; kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 28.7.2004, për apartament me sip. 126 m², Rr. “****”, Tiranë, në vlerën 56.700 euro; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 28.3.2004 (aneksi nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së); kontratë kredie nr. ***, datë 28.2.2005, me BKT-në; kontratë hipotekimi nr. ***, datë 28.2.2005; nxjerrje llogarie rrjedhëse në BKT në emër të z. Ardit Mustafaj (aneksi nr. 4/17 në dosjen e ILDKPKI-së); vërtetim nr. ***, datë 24.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”; kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr. ***, datë 27.9.2006, + praktika e kontratës; nxjerrje llogarie rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në emër të z. Ardit Mustafaj, për pagesat e kësteve të kredisë (aneksi nr. 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së).

²Gjithashtu, ky institucion, pas kërkesës së Komisionit, me shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2020, ka dërguar edhe procesverbalin e mbajtur me subjektin e rivlerësimit në datën 13.10.2014, si dhe të gjithë dokumentacionin shoqëruar në të cilin subjekti rezultoi të jetë pyetur thujse për të gjitha konstatimet e Komisionit në këto rezultate.

gjatë vitit 2006 kësti i fundit në vlerën 4.817 euro dhe është marrë në dorëzim apartamenti, por nuk është bërë regjistrimi akoma në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Vlera e apartamentit sipas kontratës së sipërmarrjes është 56.700 euro. Vlera e paguar realisht bashkë me disa shtesa në materialet e ndërtimit është në total 58.369 euro.”

1.2.iii Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 subjekti ka deklaruar kontratë shitje nr. ***, datë 10.12.2007, me shoqërinë “***”sh.p.k. Vlera: 6.900.000 lekë.

1.2.iv Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar kjo pasuri konfirmohet nga kontrata e shitjes³ së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 10.12.2007, me palë shitëse shoqëria “***” sh.p.k., dhe palë blerëse shtetasi Ardit Mustafaj. Sipas parashikimit kontraktor rezulton se çmimi 6.900.000 lekë⁴ është likuiduar tërësisht nga blerësi në favor të palës shitëse, jashtë zyrës noteriale. Ndërsa, kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 28.7.2004, me palë shtetasin R. B., me cilësinë e ortakut të vetëm dhe administratorit të shoqërisë “***” sh.p.k., dhe z. Ardit Mustafaj, pasqyron çmimin e apartamentit 450 euro/m², 126 m² x 450 euro/m² = 56.700 euro. Sipas kësaj kontrate kjo pasuri do të likuidohet si vijon:

- në datën 28.7.2004, në momentin e firmosjes së kësaj kontrate, do të likuidohet shuma prej 22.680 euro, e barabartë me 40 % të vlerës që do të paguhej;

- 14.000 euro, e barabartë kjo me përafërsisht 24 % të vlerës, që do të paguhej brenda tetorit të vitit 2004;

- 14.350 euro, e barabartë me përafërsisht 26 % të vlerës, që do të paguhej brenda shkurtit të vitit 2004;

- 5.670 euro, e barabartë me 10 % e vlerës, që do të paguhej në momentin kur të bëhet kalimi i pronësisë në emër të porositësit.

1.2.v Nga korrespondenca e mbajtur me institucionet publike ka rezultuar si vijon:

12.v.a Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2019, ka konfirmuar ekzistencën e kësaj pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit, duke saktësuar se nga verifikimi i kryer rezulton se z. Ardit I. Mustafaj ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë me të dhënat si më poshtë:

- pasuria apartament, me sip. 126 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

1.2.vi UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2019, identifikon një abonent me kontratë nr. ***, me adresë: Rr. “***”, p. ***. Për këtë numër kontrate disponohet regjistër i kontraktuesve i vitit 2006, ku pasqyrohet emër/mbiemër i abonentit dhe numri i kontratës.

1.2.vii OSHEE-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2019, sqaron se me gjeneralitetet Ardit Mustafaj, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me kontratën e furnizimit nr. ***, në instancën Tiranë. Kjo kontratë rezulton me datë hapjeje 24.4.2006 dhe është aktive.

³Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴Shuma 6.900.000 lekë është konvertim i shumës 56.700 euro, me përafërsi, sepse pagesat janë kryer përgjatë viteve 2004-2006 dhe kursi i këmbimit ka pasur ndryshime.

➤ **Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie**

1.3 Komisioni, për një hetim objektiv dhe gjithëpërfshirës, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve në raport me dokumentacionin provues, hetoi në lidhje me secilin nga burimet e krijimit të kësaj pasurie sipas deklaramit të subjektit.

a. Në lidhje me kredinë e marrë nga BKT-ja (e shlyer plotësisht), deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri

1.3.i Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ, kjo kredi konfirmohet me kontratën⁵ nr. ***, datë 28.2.2005, në shumën 20.000 euro, e akorduar me një afat 120 muaj (10 vjet), me qëllim blerje apartamenti.

1.3.ii Sipas kësaj kontrate, subjekti, si garanci hipotekore kishte vendosur pasurinë apartament me sip. 54 m², me vendndodhje në qytetin e Sarandës.

1.3.iii BKT-ja, me shkresën nr.***prot., datë 13.5.2019, ka konfirmuar disbursimin e kredisë në datën 4.3.2005, në shumën 19.600 euro dhe shlyerjen e saj në datën 24.10.2006.

1.3.iv Po në datën 4.3.2005 subjekti ka kryer transaksionin në favor të shoqërisë ndërtimore në shumën 14.350 euro, me përshkrimin “shlyerje e kësaj për blerjen e apartamentit”.

1.3.v Në analizë të dokumentacionit të cituar dhe përshkruar më sipër, për sa kohë faktet e rezultuara nga hetimi përputheshin me deklaramin e subjekti, Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika në lidhje me përfitimin dhe shlyerjen e kësaj kredie, e përdorur si burim krijimi për këtë pasuri. Në të tilla kushte, trupi gjykues konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi këtë burim krijimi të pasurisë.

b. Në lidhje me kredinë e marrë nga “Raiffeisen Bank”, në shumën 5.000.000 lekë, deklaruar si burim tjetër të krijimit të kësaj pasurie

1.4 Komisioni, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar lidhur me përfitimin e kredisë, ka konstatuar se kjo kredi, konfirmohet me kontratën e kredisë bankare⁶ dhe hipotekës nr. ***, datë 27.9.2006. Është konstatuar se kredia është miratuar në shumën 5.000.000 lekë dhe është akorduar për një afat 300 muaj (25 vjet), me përshkrimin “për blerje apartamenti”.

1.4.i Komisionit i rezultoi se për këtë kredi subjekti ka vendosur garanci hipotekore: (a) pasurinë apartament me sip. 54 m², me vendndodhje në Sarandë, ku kjo e fundit ishte bllokuar në favor të “Bankës Kombëtare Tregtare”, për t’u çliruar prej saj në momentin e shlyerjes së detyrimit me kredinë e aprovuar nga “RaiffeisenBank”; dhe (b) pasurinë apartament me sip. 65 m² në Sarandë, në bashkëpronësi të shtetasve M. M., K. M. dhe A. M., përkatësisht prindërit dhe vëllai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

⁵Aneks 4/17 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶Shkresë nr. *** prot., datë 7.5.2019, nga “Raiffesien Bank”.

1.4.ii “Raiffeisen Bank”, në korrespondencën e saj, konfirmon disbursimin e kredisë në datën 18.10.2006, në shumën 5.000.000 lekë, dhe tërheqjen në datën 20.10.2006 nga subjekti të shumës 4.810.000 lekë.

1.4.iii Sipas kontratës së kredisë, vërehet se kjo kredi është përfituar me kushte lehtësuese. Në mbështetje të legjitimitit të përfitimit të saj, subjekti ka depozituar⁷ listën e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, të miratuar nga titullari i institucionit punëdhënës, ku identifikoheshin gjyqtarë të cilët kanë pasur nevojë për kredi për banesë.

1.4.iv Lista është shoqëruar edhe me kërkesën e kryetarit të këtij institucioni për trajtimin me strehim për t’i dhënë kredi për banesë të listuarve në shkresë.

1.4.v Nga korrespondencat bankare vihet re se subjekti në datën 24.10.2006, nga kredia lehtësuese ka depozituar në BKT shumën 18.160 euro, për të mbyllur parakohe kredinë e marrë në këtë bankë, në shumën 20.000 euro.

1.4.vi Po ashtu, ka rezultuar se kjo kredi është përdorur për të shlyer shumën 2.000.000 lekë, të marrë hua shtetasit A. M. në vitet 2003 – 2004, ku në fakt për këtë pasuri është përdorur vetëm shuma 1.000.000 lekë. Ndërsa, në deklaratën periodike të vitit 2006 subjekti ka deklaruar se me këtë kredi ka shlyer edhe pjesë nga huaja e marrë shtetasit Gj. D., hua e cila nuk ka qenë burim i kësaj pasurie.

1.4.vii Komisionit i ka rezultuar se kredia në shumën 5.000.000 lekë është përfituar pasi subjekti kishte nënshkruar kontratën e sipërmarrjes për këtë pasuri dhe pasi kishte paguar shumën 53.552 euro nga shuma totale prej 58.369 euro⁸ (qartësohet se shuma 58.369 euro përbëhet nga 56.700 euro sipas çmimit në kontratën e sipërmarrjes + 2.522 euro të deklaruara nga subjekti në vitin 2005, si pagesë shtesë për pllakat).

1.4.viii Pra, subjekti me këtë kredi rezultoi të kishte paguar vetëm shumën e mbetur pa paguar për këtë pasuri, gjithsej në vlerën 4.817 euro.

1.4.ix Është vërejtur se kredia vazhdon të shlyhet edhe aktualisht.

1.4.x Nga hetimi ka rezultuar se në kohën e përfitimit të kësaj kredie, pasuria ende nuk ishte regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, por që prej këtij të fundit është marrë në dorëzim po në vitin 2006, sikurse subjekti ka deklaruar në deklaratën për vitin 2006, vit në të cilin ka marrë kredinë lehtësuese.

1.4.xi Sipas shkresës së kryetarit të gjykatës kërkimi për përfitimin e kredisë për disa gjyqtarë, ku ndër të tjera është cituar edhe subjekti i rivlerësimit, është bërë bazuar në VKM-në nr. 102/1999, duke u cituar rrethana të cilat impononin domosdoshmërinë e dhënies së banesave, për shkak se të listuarit jetonin në kushte të vështira ekonomike, për shkak të mungesës së tyre, duke u cenuar siguria dhe integriteti personal dhe familjar i tyre. Po ashtu, në shkresë pasqyrohet edhe fakti i mos hartimit të paketës ligjore për këtë kategori. Sipas kontratës së kredisë të vitit 2006, shuma 5.000.000 lekë është miratuar në favor të kredimarrësit me qëllim përdorimin e saj për blerje apartamenti (shihni pikën 1.1 të kontratës), ndërsa subjekti kishte

⁷Pyetësor nr. 2, datë 18.12.2019.

⁸Pika 2, e VKM-së nr.102/1999, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, e ndryshuar, citon shprehimisht: “Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore të përmendur më sipër janë në këto funksione dhe janë pa banesë ..., u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti.” Pika 6 e po këtij akti nënligjor citon shprehimisht: “Kredia jepet me vlerë deri në 5 milionë lekë, me interes 3 përqind dhe afat kthimi deri në 25 vjet për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, që nuk kanë banesë”

porositur apartamentin që prej vitit 2004, kishte shlyer thuajse të gjithë pagesat e kësteve për këtë apartament, fakte të cilat nuk duket të jenë bërë prezent dhe, për pasojë, ai është renditur në kushtet e emergjencës në shkresën e kryetarit të gjykatës.

1.4.xii Për të gjithë faktet e sipërpërmendura, për të qartësuar çdo situatë në lidhje me përfitimin dhe destinacionin e kësaj kredie, apo edhe për të provuar të kundërtën, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës⁹, pasi: dukej se kredia nuk ishte përdorur për qëllimin për të cilin ajo ishte marrë “për blerje banese”, për shkak se thuajse të gjithë këstet për blerjen e pasurisë ishin paguar dhe se me të ishin shlyer edhe hua të cilat nuk ishin deklaruar nga subjekti si burim i kësaj pasurie; dukej se subjekti kishte aplikuar në kundërshtim me kriteret ligjore të VKM-së nr.102, datë 5.3.1999, i ndryshuar, për përfitimin e kredisë lehtësuese, pasi kishte porositur këtë pasuri që në vitin 2004, e zotëronte atë, si dhe kishte shlyer pothuajse të gjithë këstet përkatëse; se mungonte dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit pranë punëdhënësit, pas të cilit ishte përfshirë në listimin e aplikantëve për të marrë kredinë lehtësuese.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.4.xiii Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, për të kundërshtuar konstatimet e Komisionit, ka parashtruar se në datën 1.1.2004 është transferuar me punë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe se në këtë qytet nuk kishte banesë. Për këtë shkak subjekti është shprehur se ka qëndruar në banesën e prindërve deri në fund të vitit 2006.

1.4.xiv Subjekti ka sqaruar se kishte synuar të prenotonte një apartament që ishte në fazat e para të ndërtimit, për shkakun se:

- nuk kishte pasur mundësi financiare për të paguar të gjithë shumën njëherësh në rastin e një apartamenti të përfunduar;
- marrja e një kredie në një vlerë shumë të madhe (për një apartament të përfunduar) do të kishte qenë shumë e vështirë për t'u përballuar prej tij, pasi këstet mujore do të ishin shumë të larta;
- pagesa e një apartamenti në ndërtim e sipër do të bëhej pjesë-pjesë dhe i krijonte më shumë mundësi në kohë që të përballonte pagesat;
- çmimi i një apartamenti në fillim të ndërtimit të tij do të ishte më i ulët sesa në përfundim, pasi pas 2-3 vjetësh, kur të përfundonte apartamenti, çmimet e tregut do të kishin qenë më të larta;
- në pritje të përfundimit të apartamentit, së bashku me familjen do të jetonte te prindërit dhe nuk do të kishte shpenzime qiraje, energjie elektrike, uji, etj.;
- në këtë kohë (fillimi i vitit 2004) kishte qenë në pritje të akordimit nga shteti të kredive me kushte lehtësuese për shkak të detyrës, si një premtim i qeverisë për të siguruar kushte të përshtatshme pune dhe strehimi për gjyqtarët e institucionit të ri që u krijua në vitin 2004, por nuk dihej me saktësi se kur do të ndodhte kjo.

1.4.xv Për arsyet e mësipërme, subjekti ka kërkuar për pallate në fazat e para të ndërtimit dhe ka konstatuar në fillimet e ndërtimit të tij pallatin ku banon aktualisht, duke lidhur kontratën e sipërmarrjes së deklaruar prej tij. Subjekti, ndërkohë ka shpjeguar që nuk ishte akorduar ende kredia me kushte lehtësuese, dhe bashkë me bashkëshorten, për të përballuar pagesat e kësteve të apartamentit kanë angazhuar të gjitha burimet e mundshme financiare që kishim në dispozicion, si dhe ato që mund të siguronim përmes shitjeve, marrjes së huave dhe kredive të

⁹Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

ndryshme apo përmes shtyrjes në kohë të kthimit të huave të marra më parë nga të afërmit dhe përdorimit të shumave përkatëse për të paguar këstet e apartamentit. Në kohën e dhënies së kredisë nga “Raiffeisen Bank” në tetor të vitit 2006, i gjithë detyrimi financiar i akumuluar ka qenë pikërisht për shkak dhe në funksion të pagesës së kësteve të këtij apartamenti. Në këto kushte, me marrjen e kredisë, subjekti ka shlyer këto detyrime që ishin akumuluar për qëllimin e blerjes së apartamentit dhe ka paguar këstin e fundit të tij. Subjekti ka qartësuar se: *“Këtë kredi e kam përdorur tërësisht për strehim dhe vetëm në funksion të apartamentit në të cilin banoj. Nuk kam blerë pasuri të tjera me kredinë në fjalë.”*

Pretendimi i Komisionit se *duket se kredia nuk është përdorur për qëllimin për të cilin ajo është marrë “për blerje banese”, pasi thuajse të gjithë këstet për blerjen e pasurisë ishin paguar dhe se me të janë shlyer edhe hua të cilat nuk janë deklaruar nga subjekti si burim i kësaj pasurie*, nuk qëndron. Për pagimin e kësteve të apartamentit ishin përdorur edhe huaja në shumën 1.000.000 lekë, marrë në vitin 2004 nga kunati i subjektit, z. A. M., dhe kredia në shumën 20.000 euro e marrë në vitin 2005 në BKT, të cilat u likuiduan tërësisht me kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2006. Po kështu, edhe huaja prej 1.000.000 lekësh e marrë nga kunati i subjektit, z. A. M., në vitin 2003 është përdorur përgjithësisht në funksion të objektit të papërfunduar 1+1 në Sarandë, të cilin e ka shitur në mars të vitit 2004, dhe vlera e marrë nga shitja e tij është përdorur në funksion të pagimit të kësteve të apartamentit në Tiranë. Edhe pjesa e mbetur në vitin 2006 nga huaja e marrë prej 340.000 lekësh nga shtetasi Gj. D., që u likuidua tërësisht me marrjen e kredisë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2006, ishte pjesë e vlerës së përdorur nga kjo hua për objektin e papërfunduar 1+1, që u shit në vitin 2004 (vlera e shitjes të këtij të fundit u përdor në funksion të pagimit të kësteve të apartamentit).

1.4.xvi Subjekti ka shpjeguar edhe në lidhje me konstatimin tjetër të Komisionit se *duket se subjekti ka aplikuar në kundërshtim me kriteret ligjore të VKM-së nr.102, datë 5.3.1999, i ndryshuar, për përfitimin e kredisë lehtësuese, pasi kishte porositur këtë pasuri që në vitin 2004, e posedonte atë, si dhe kishte shlyer pothuajse të gjithë këstet përkatëse*, duke pretenduar se nuk qëndron. Për këtë ka paraqitur një historik të banimit të tij në qytetin e Tiranës, duke saktësuar se nuk ka pasur banesë tjetër në këtë qytet, se nuk e posedonte apartamentin në kohën e marrjes së kredisë në tetor të vitit 2006, madje duke e konsideruar se ky konstatim i Komisionit për të, në vetvete nuk kishte asnjë lidhje me çështjen. Subjekti ka pretenduar se nuk ka asnjë aplikim në kundërshtim me kriteret ligjore të VKM-së nr.102, datë 5.3.1999, dhe ka shpjeguar edhe në procesverbalin e deklarimit në ILDKPKI në datën 13.10.2014 se për dhënien e kredisë me kushte lehtësuese ka pasur vetëm një korrespondencë nga drejtuesi i gjykatës me institucionet përkatëse. Subjekti ka qartësuar se në institucionin e gjykatës askujt nuk i është kërkuar dhe as nuk ka paraqitur kërkesë apo dokumentacion për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, por kërkesa për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese është e kryetarit të gjykatës drejtuar institucioneve të mësipërme (citim nga shkresat: *“kërkojmë nga ana juaj që t’i përcillet Këshillit të Ministrave kërkesa që gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda të trajtohen me kredi banese në rrethana lehtësuese sipas VKM-së nr.102, datë 5.3.1999 ...”*). Kjo situatë është e njëjtë për të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, përfshirë edhe subjektin. Në listë janë emrat e të gjithë gjyqtarëve që punonin në atë periudhë në këtë gjykatë, përveç 4 gjyqtarëve që kredinë me kushte lehtësuese e kishin përfituar në të njëjtën mënyrë, një apo dy vite më parë. Prandaj, në rastin konkret, nuk qëndron as konstatimi i Komisionit se *mungon dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit pranë punëdhënësit, pas të cilit është përfshirë në listimin e aplikantëve për të marrë kredinë lehtësuese*.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.4.xvii Nisur nga provat e administruara në dosje, deklaratimet e subjektit përpara dhe gjatë hetimit administrativ, konstatimet e bëra në rezultatet e hetimit, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, trupi gjykues, në tërësi të kësaj çështjeje, arsyeton si vijon:

1.4.xviii Faktet e dala nga hetimi administrativ se subjekti kishte porositur një apartament në Tiranë prej vitit 2004, dhe se deri në përfitimin e kësaj kredie për shkak të detyrës, rezultoi se kishte paguar thuajse të gjithë këstet e saj, duke shlyer para kohe kredinë e përfituar në vitin 2004 në BKT, në shumën 20.000 euro, me normë interesi si të gjithë shtetasit e tjerë në territor vendi, si dhe shlyerjen e huave të marra, pasqyrojnë veprime të cilat tregojnë se destinacioni i kësaj kredie nuk ka qenë në përmbushje të plotë dhe strikte të qëllimit të përfitimit të saj.

1.4.xix Komisioni, faktet e dala nga hetimi në raport me shpjegimet e dhëna nga subjekti, i vlerësoi edhe nën kontekstin se të gjitha veprimet financiare janë realizuar në mënyrë të ndërsjellë me njëra-tjetrën, me palët (huadhënësit) që kanë investuar në porositjen e kësaj pasurie, të cilat në përfundim kanë derivuar në zotërimin e një banese të vetme në qytetin e Tiranës, e prenotuar që prej vitit 2004, duke konsideruar në këtë mënyrë qartësimin e subjektit që, me kredinë lehtësuese ai pranon se ka paguar huatë apo edhe kredinë e parë.

1.4.xx Komisioni, ligjshmërinë e përfitimit të kësaj kredie, e konkretisht përmbushjen e parashikimeve ligjore të VKM-së nr. 102/1999, se kredia me kushte lehtësuese mund të përfitohej nëse subjekti do të ishte pa banesë, pra ky trajtim i ashtuquajtur preferencial, i mundësohej një subjekti i cili nuk dispononte pasuri në teritorr vendi, e ka vlerësuar edhe në raport me zhvillimin e mëtejshëm të legjislacionit në këtë fushë, arsyetuar më poshtë.

1.4.xxi Ndërsa në aspektin formal për të kuptuar nëse subjekti në aplikimin e tij e kishte qartësuar këtë moment, pra, faktin që kishte një apartament, trupi gjykues, kryesisht pas parashtrimeve të subjektit, vëren se ai nuk arriti të shpjegojë dhe të provojë me dokumentacion justifikues faktin e depozitimit të kërkesës apo aplikimit të tij në institucionin punëdhënës apo nuk arriti të provojë pretendimin e tij se prirja e përfitimit të kësaj kredie kishte nisur prej vitit 2004, në një kohë që të gjithë shkresat e drejtuesit të institucionit për përfitimin me kredi lehtësuese të gjyqtarëve të kësaj gjykate, datonin në vitin 2006.

1.4.xxii Subjekti pretendon se *në institucionin e gjykatës askujt nuk i është kërkuar dhe as nuk ka paraqitur kërkesë apo dokumentacion për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, por kërkesa¹⁰ për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese është e kryetarit të gjykatës drejtuar institucioneve.*

1.4.xxiii Trupi gjykues çmon se edhe sikur kjo mënyrë përfitimi kredie të ishte iniciativë e drejtuesit të institucionit, përsëri një kërkesë për shkak të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe kriterëve të përcaktuara në VKM-në përkatëse, duhej të ishte dorëzuar, për më tepër edhe për të qartësuar statusin e banimit në momentin e aplikimit.

1.4.xxiv Përfitimi i kredisë në vitin 2006, në ndryshim nga një aplikim i mundshëm në vitin 2004, e gjeti subjektin me apartamentin tanimë jo vetëm të porositur, por edhe thuajse tërësisht të shlyer.

¹⁰Korrespondencë, tri shkresa të drejtuara nga kryetari i gjykatës zv. kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë të Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave, respektivisht me nr. *** prot., datë 19.5.2006, nr. *** prot., datë 19.5.2006, nr. *** prot., datë 19.5.2006, dhe bashkëngjitur tyre lista e gjyqtarëve.

1.4.xxv Pra, parë në këtë këndvështrim, trupi gjykues çmon se subjekti nuk mund ta përfitonte këtë kredi. Por, nga ana tjetër, trupi gjykues, në analizë të faktit se në vitin 2004 subjekti ka aplikuar për të marrë kredi me normë interesi si çdo shtetas tjetër dhe duke vërejtur veprimet e mëtejshme të tij, vlerëson se bazuar në rrethanat e konstatuara së fundmi rezulton se kjo kredi ka mbuluar më së shumti të vetmen pasuri të blerë nga subjekti në qytetin e Tiranës.

1.4.xxvi Nën këtë arsyetim, por edhe duke iu referuar zhvillimit të mëtejshëm të legjislacionit pas vitit 1999 (2007 e në vijim), për të lejuar këtë kategori personash të përfitonin kredi me kushte lehtësuese në vendin e ushtrimit të profesionit, pavarësisht se mund të kishin një tjetër pasuri në ndonjë qytet tjetër, nga ku vërehet se tendencat e legjislatorit kanë synuar lehtësimin e kësaj kategorie në mënyrën e përfitimit të banesës, trupi gjykues çmon të konsiderojë provat shkresore, si dhe deklaratimet me vërtetësi të subjektit, lidhur me destinacionin e kredisë, në harmoni me legjislacionin që i referohet kohës së përfitimit të saj, duke u prirë edhe nga zhvillimi i mëtejshëm i tij dhe kategorizuar rastin në favor të subjektit me konkluzionin si vijon:

1.4.xxvii Duke mbajtur në konsideratë faktin se të gjitha provat dhe rrethanat e kanë kushtëzuar subjektin në të vetmen banesë në vendin e ushtrimit të profesionit, në qytetin e Tiranës, si përpara edhe pas marrjes së kredisë me kushte lehtësuese, trupi gjykues çmon se në rrethanat faktike të kësaj çështje, nuk mund të arrihet në një konkluzion se kredia e përfituar është në kushtet e paligjshmërisë.

1.4.xxviii Në këtë vlerësim, trupi gjykues, sikurse ka cituar më sipër, ka në konsideratë se qëllimi i ligjbërësit ka qenë se kredia lehtësuese përfitohet e konceptuar si një ndihmë e mbështetje që shteti e ofronte për funksionarët e tij në kushte të pamundësisë apo vështirësisë për të siguruar strehimin me burimet e tyre financiare. Në këtë kuptim, veprimet e ndërsjella të subjektit, si kreditë apo huat, dëshmojnë pamundësinë e tij financiare dhe rrethanat në tërësi të çështjes objekt vlerësimi tregojnë vështirësitë e tij për të siguruar strehim. Nën këtë arsyetim dhe çmuarjes se të gjitha veprimet e subjektit kanë derivuar në banesën e vetme për strehim, trupi gjykues çmon se nuk ka rrethana të mjaftueshme për ta ngarkuar me përgjegjësi subjektin.

c. Në lidhje me të ardhura familjare nga puna, të deklaruara si burim tjetër për krijimin e kësaj pasurie

1.5 Komisionit, gjatë hetimit, i ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore, ku nga korrespondencat institucionale (nga punëdhënësit përkatës) janë pasqyruar dhe konfirmuar të ardhurat e tyre. Në të tilla kushte, Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare (tabela nr. 4) të ardhurat e përdorura për investimin e kryer.

✓ Në analizë të dokumentacionit provues, trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika lidhur me të ardhurat e konfirmuara zyrtarisht nga institucionet punëdhënëse.

d. Në lidhje me të ardhura nga qiraja, të deklaruara si burimi i radhës për krijimin e kësaj pasurie

1.6 Komisioni, gjatë hetimit administrativ për vërtetësinë dhe ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave, ka konstatuar se këto të ardhura janë vetëdeklaruar nga subjekti në deklaratat periodike të viteve 2004, 2005 dhe 2006, ku rezulton se nga pasuria me sip. 54 m² në qytetin e Sarandës ka përfituar në total shumën bruto prej 420.000 lekësh. Por, nga ana tjetër, ka vërejtur se këto të ardhura nuk janë konfirmuar me kontratë qiraje. Gjithashtu, nga verifikimet e

dokumentacionit tatimor, Komisionit i ka rezultuar se tatimi mbi këto të ardhura është paguar¹¹ nga subjekti në vitin 2014, në shumën 42.000 lekë.

1.6.i Trupi gjykues, në analizë të deklarimeve periodike të subjektit lidhur me krijimin dhe përfitimin e këtyre të ardhurave, në analizë të dokumentacionit tatimor dhe legjislacionit mbi të cilin subjekti i është nënshtruar rivlerësimit, vlerëson faktin se subjekti ka deklaruar në kohë reale përfitimin e të ardhurave, pra, në vitet përkatëse 2004, 2005 dhe 2006, argument që ngre nivelin e provueshmërisë së krijimit të këtyre të ardhurave. Po ashtu, trupi gjykues, i ndodhur përpara faktit të pagimit të detyrimit tatimor të këtyre të ardhurave të përfituara prej vitit 2014, kohë përpara se procesi i rivlerësimit të fillonte, është një tjetër argument në favor të subjektit të rivlerësimit, çka ndikon pozitivisht në provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave. Në këndvështrim të zbatimit të ligjit nr. 84/2016, si dhe Udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Lartë të ILDKPKI-së, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku kërkohet depozitimi i saktë i deklaratës “Vetting”, së bashku me dokumentacionin e plotë provues në mbështetje të deklarimeve pasurore, trupi gjykues përsëri vlerëson po të njëjtin fakt, pagesën e detyrimit tatimor të të ardhurave të përfituara nga qiraja, shumë kohë më përpara daljes së ligjit, duke i paraprirë përmbushjes së kërkesave të këtij ligji, pa pasur dijeni për të. Edhe nga pikëpamja e zbatimit të legjislacionit civil¹², një argument i cili konsiderohet nga trupi gjykues, është edhe fakti se deklarimi në mënyrë periodike i të ardhurave të përfituara duket se përkon me kontrata njëvjeçare, të cilat jo domosdoshmërisht kërkohet të jenë të lidhur në formën e kërkuar nga ligji, pasi ato në raste të tilla gjejnë mirëkuptimin e palëve, administrohen dhe zbatohen në heshtje, me mirëbesim midis palëve kontraktore, për sa kohë rezultojnë të efektshme.

- Për të gjitha arsyet e sipërpërmendura:

✓ Trupi gjykues çmon se të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga dhënia me qira e apartamentit në qytetin e Sarandës, janë të ligjshme dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, si dhe pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

e. Në lidhje me shitjen e objektit 1+1, sipas kontratës nr. *, datë 28.3.2004, të ardhurat e të cilës janë deklaruar si një ndër burimet e kësaj pasurie**

1.7 Komisionit, gjatë hetimit dhe verifikimit të dokumentacionit të administruar, i ka rezultuar se këtë pasuri subjekti e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, me përshkrimin “objekt banese e papërfunduar tërësisht me nr. katesh 1 + 1, me sip. 120 m² dhe truall me sip. 304 m²”, në vlerën 1.800.000 lekë.

1.7.i Në vijim është konstatuar se subjekti në deklaratën periodike të vitit 2004, ka deklaruar: *shitur një objekt i papërfunduar banese, me nr. katesh 1+1, me sipërfaqe ndërtimi 120 m², me sipërfaqe trualli 304 m² në Sarandë, zona ***. Vlera: 1.850.000 lekë.*

1.7.ii Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ rezulton se shitja e kësaj pasurie konfirmohet me kontratën e shitblerjes¹³ (pasuri e paluajtshme) nr. ***, datë 28.3.2004,

¹¹Aneks 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹²Referuar Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 803, paragrafi i fundit, ku thuhet shprehimisht: “Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë.”

¹³Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

me palë shitëse shtetasit Ardit Mustafaj dhe S. M., përfaqësuar me prokurën nr. ***, datë 28.3.2004 nga shtetasi A. M. dhe palë blerëse shtetasi P. G., me përshkrimin “prona që shitet banesë, me nr. katesh 1+1 e ndodhur në Sarandë, në zonën ***, blloku nr. ***, parcela ***, me sipërfaqe ndërtimi 120 m² dhe sipërfaqe trualli në funksion 304 m². Çmimi i shitjes 1.800.000 lekë¹⁴, shumë e marrë tërësisht jashtë zyrës noteriale”.

1.7.iii Në analizë të kontratës së shitjes, e cila për nga forma, por edhe nga pasojat e prodhuara, rezulton konform legjislacionit civil, pasi ka parashikuar palët kontraktore, objektin, ka përcaktuar vlerën e shitjes së pasurisë, është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve, duke u regjistruar në hipotekë në favor të blerësit, trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- ✓ Subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi marrëdhënien kontraktore të shitjes së pasurisë, nga e cila është përfituar shuma prej 1.800.000 lekësh, e përdorur gjithashtu si një ndër burimet e krijimit të kësaj pasurie.

f. Në lidhje me burimin tjetër të krijimit të pasurisë, apartament në qytetin e Tiranës, hua në shumën 1.000.000 lekë nga shtetasi A. M. (e kthyer plotësisht)

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë hua

1.8 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 subjekti ka deklaruar këtë hua të marrë nga shtetasi A. M. (vëllai i bashkëshortes së subjektit), por pa përcaktuar qëllimin e përdorimit.

1.8.i Në deklaratimet e tij periodike subjekti ka deklaruar disa huamarrje. Komisioni e ka pyetur¹⁵ subjektin lidhur me qëllimin e marrjes së kësaj huaje, si dhe lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të saj. Subjekti ka deklaruar se shuma prej 1.000.000 lekësh e marrë në vitin 2004 (në muajin mars) nga shtetasi A. M. është përdorur e gjitha në funksion të pagesës së kësteve të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 28.7.2004.

1.8.ii Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka marrë disa hua nga ky huadhënës, përkatësisht në vitet 2003, 2004 dhe 2007¹⁶, sikurse paraqitet në tabelën e mëposhtme, por që në këtë rast trajtohet vetëm njëra prej shumave të marra, konkretisht shuma 1.000.000 lekë, e përdorur për këtë pasuri.

Tabela nr. 1

Data e dhënies së huas	Shuma e marrë	Shuma e shlyer	Dokumentacioni justifikues
Gusht 2003	1,000,000		Kontratë huadhënieje nr. ***, datë 20.3.2006
Mars 2004	1,000,000		Kontratë huadhënieje nr. ***, datë 20.3.2006
31.10.2006		2,000,000	Deklaratë noteriale nr. ***, datë 31.10.2006
10.12.2007	1,000,000		Kontratë huaje nr. ***, datë 10.12.2007
23.8.2010		1,000,000	Deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.8.2010

¹⁴Këto të ardhura u përfshinë në analizën financiare në fazën e hetimit administrativ dhe në dërgimin e rezultateve të hetimit.

¹⁵Pyetësor nr. 2, datë 18.12.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁶Huaja e vitit 2007 është analizuar në pasurinë nr. 2.

1.8.iii Me qëllim provueshmërinë e burimit të ligjshëm të të ardhurave, subjekti ka depozituar¹⁷ dokumentacionin përkatës për të provuar punësimet e huadhënësit, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të tij për secilën nga punët e kryera: agjent doganor në agjencinë detare dhe spedicionere “****” sh.p.k.; mekanik në tragetin “****”, të shoqërisë greke që kryente linjën e udhëtarëve Korfuz-Sarandë; inxhinier mekanik dhe kryeinxhinier në Ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Sarandë; si dhe i punësuar *part time* në shoqërinë “****” sh.p.k.

1.8.iv Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit të depozituar, kreu analizën financiare me të ardhurat nga punësimi deri në mars të vitit 2004 (periudhë që përfshin të dyja huadhëniet, të marra në vitet 2003 dhe 2004, të përdorura përkatësisht në vitin 2003 për ndërtimin e objektit në qytetin e Sarandës në shumën 1.800.000 lekë, dhe në vitin 2004 për shlyerjen e këstit të kësaj pasurie, për të cilën po analizohen burimet), në pamundësi për t’i ndarë për secilin vit.

1.8.v Në lidhje me punësimin e huadhënësit në periudhën janar 1998 – maj 2001 si mekanik në tragetin “****” etj., dokumentacionet e depozituara nga subjekti, më konkretisht, deklaratat e lëshuara nga kapitenët e anijes, deklarojnë shumatat me të cilat ata vetë janë paguar, si dhe faktin që shtetasi A. M. ka punuar në këtë anije dhe pagën me të cilën është paguar ky i fundit. Aktet e depozituara nga subjekti duket se synojnë të provojnë në mënyrë indirekte punësimin e huadhënësit me pagë mujore 150.000 dhrahmi greke (rreth 75.000 lekë sipas kursit mesatar¹⁸ të Bankës së Shqipërisë në vitin 1998), por nuk dokumentohet dhënia e kësaj shume nga punëdhënësi, dhe po ashtu duket se nuk provohet edhe pagimi i detyrimeve tatimore.

1.8.vi Në kushte të tilla, Komisioni, vlerësoi të mos përfshijë të ardhurat e siguruar nga ky punësim në analizën financiare.

1.8.vii Ndërsa, nga verifikimi i dokumentacionit për të ardhurat nga punësimi i huadhënësit si agjent doganor në agjencinë detare dhe spedicionere “****” sh.p.k., dhe Ujësjetllës Kanalizime Sarandë rezultoi, si më poshtë:

Tabela nr. 2

Viti	Paga vjetore	Institucioni punëdhënës
1996	60,000	“****” sh.p.k., agjent doganor
1997	60,000	
Qershor 2001	112,548	Ujësjetllës Kanalizime, Sarandë
2002	277,136	
2003	417,872	
Mars 2004	96,432	
	1,023,988	

1.8.viii Nisur nga sa më sipër, totali i të ardhurave për periudhën 1996 – mars 2004, rezultoi në shumën 1.023.988 lekë, shumë kjo e cila lehtësisht dukej se nuk e mbulonte huan në vlerën 2.000.000 lekë. Këtyre të ardhurave nuk i janë zbritur shpenzimet e jetesës apo ndonjë investim i mundshëm i kryer nga huadhënësi. Mbi këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit barrën e

¹⁷Pyetësor nr. 2, datë 18.12.2019, së bashku me dokumentacionin mbështetës.

¹⁸https://www.bankofalbania.org/tregjet/kursi_zyrtar_i_këmbimit/arkiva_e_kursit_të_këmbimit/

provës¹⁹ për të dhënë argumentet e tij, pasi dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i shumës 2.000.000 lekë të dhënë hua në vitin 2003 – 2004, nga shtetasi A. M. dhe se mungonte dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.8.ix Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit, duke sqaruar se huat e marra nga shtetasi A. M. i ka deklaruar që në vitet 2003 dhe 2004, në deklaratën e parë vjetore të pasurisë, 13 vjet përpara miratimit të ligjeve për Reformën në Drejtësi.

1.8.x Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti është shprehur se ka deklaruar saktë huan në shumën 1.000.000 lekë, të marrë nga shtetasi A. M. (vëllai i bashkëshortes së subjektit).

1.8.xi Në deklarinimin e pasurisë së vitit 2004 subjekti është shprehur se ka deklaruar saktë shumën tjetër të huas prej 1.000.000 lekësh, të marrë nga shtetasi A. M. . Madje në deklarinimin e pasurisë së vitit 2004 subjekti ka shënuar edhe numrin e kontaktit (nr. i celularit) të tij, në mënyrë që ILDKPKI-ja të verifikonte që në atë kohë drejtpërdrejt të gjitha faktet që lidheshin me huadhënësin, ashtu sikurse ka vendosur numrin e kontaktit (nr. i celularit) edhe për huadhënësin tjetër, shtetasin Gj. D. .

1.8.xii Në deklarinimet e pasurisë së vitit 2006, subjekti është shprehur se ka deklaruar me saktësi likuidimet e bëra për shlyerjen e të dy huave të marra nga shtetasi A. M. me kontratë noteriale. Të dhënat e mësipërme lidhur me huat, lidhur me kthimet e tyre dhe lidhur me punësimet e shtetasit A. M., subjekti ka shpjeguar se ka deklaruar me saktësi të plotë edhe në sqarimet e dhëna në ILDKPKI, në datën 13.10.2014. Të njëjta të dhëna, është shprehur subjekti, i ka deklaruar edhe në deklaratën e pasurisë për rivlerësim të vitit 2006 dhe në përgjigjet e pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

1.8.xiii Konstatimi i Komisionit për mungesën e dokumentacionit justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua nga vëllai i bashkëshortes në vlerën 2.000.000 lekë nuk qëndron, pasi vëllai i bashkëshortes së subjektit, z. A. M., ka paraqitur gjithë dokumentacionin e mundshëm për të provuar punësimin e tij të pandërprerë gjatë viteve 1995 – 2004. Këtë dokumentacion subjekti e ka bërë prezent përpara Komisionit.

Në lidhje me punësimin në periudhën janar 1998 – maj 2001, në tragetin “****”, që ka kryer linjën Korfuz-Sarandë, Komisioni, duke u mbështetur vetëm në deklaratat noteriale të kapitenit të tragecit dhe marinarëve (G. M., S. Z., I. T.), të paraqitura prej subjektit, konkludon se *nuk dokumentohet dhënia e kësaj shume nga punëdhënësi*. Por, Komisioni nuk e analizon shkresën zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme Detare Durrës, që vërteton se trageci “****” ka kryer nga viti 1998 – 2001 linjën Korfuz-Sarandë, me frekuencë lëvizjeje pothuaj të përditshme, me kapiten shtetasin G. M., pikërisht një nga deklaruesit. Komisioni nuk ka analizuar as dokumentin zyrtar me nr. ***, datë 28.1.1998, të lëshuar nga Autoriteti Portual Korfuz “*Seaman’sdockpass*” (*lejedalje në port*), sipas të cilit vërtetohet zyrtarisht se shtetasi A. M., i biri i M., i datëlindjes 1971, me nr. pasaporte ***, me kombësi shqiptare, është marinar në tragetin “****”, anije me port regjistrimi Honduras. Komisioni nuk ka analizuar as dokumentin zyrtar të lëshuar nga kapitenaria e portit Sarandë, “*Pasaportë lundrimi/ Seaman’sbook*”, me nr. ***, datë lëshimi 22.1.1998, sipas të cilit vërtetohet zyrtarisht se shtetasi A. M., i biri i M.,

¹⁹Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

i datëlindjes 17.8.1971, lindur në Sarandë, është i mbarkuar në datën 10.1.1998 në tragetin “****”, në detyrën mekanik, në portin e Korfuzit. Këto dokumente të përmendura më sipër dhe të tjera të paraqitura nga subjekti në përgjigjet e pyetësorëve, paraqesin fakte të pakundërshtueshme që provojnë punësimin e shtetasit A. M. si marinar në tragetin “****”. Meqenëse punësimi i tij provohet katërcipërisht, sigurisht që ky person nuk ka punuar pa pagesë, nuk ka qenë vullnetar.

1.8.xiv Gjithashtu, subjekti ka qartësuar se edhe nëse Komisioni nuk merr për bazë pagën prej 150.000 dhrahmi/muaj,e konfirmuar nga dëshmitarët, atëherë t’i referohet pagës minimale mujore sipas Institutit të Statistikave të shtetit grek, përderisa vërtetohet plotësisht me dokumente zyrtare të lëshuara nga autoritetet greke dhe shqiptare se shtetasi A. M. ka punuar marinar (duke kryer detyrën e mekanikut) në tragetin “****”, në periudhën e sipërpërmendur.

1.8.xv Subjekti ka pretenduar se duke marrë parasysh të gjitha të ardhurat e krijuara nga puna prej shtetasit A. M. deri në momentin e marrjes së huas së parë në shumën prej 1.000.000 lekësh nga subjekti, rezulton shuma totale e të ardhurave të tij në vlerën 3.456.082 lekë, dhe se duke shtuar në këtë pasqyrë edhe të ardhurat e krijuara nga shtetasi A. M. nga puna e tij gjatë periudhës gusht 2003 – mars 2004, bëhet shuma 3.745.378 lekë të ardhura.

1.8.xvi Pra, subjekti është shprehur se huadhënësi me të ardhurat që ka krijuar nga puna e tij e pandërprerë ka pasur mundësi financiare për t’i dhënë huat në shumat 1.000.000 lekë në gusht të vitit 2003 dhe 1.000.000 lekë në mars të vitit 2004.

1.8.xvii Subjekti ka pretenduar se shtetasi A. M. gjatë kohës që ka punuar si marinar (mekanik) në tragetin “****” ka jetuar në këtë anije dhe si rezultat nuk ka pasur shpenzime për qira, energji elektrike, ujë, etj., që lidhen me marrjen dhe mbajtjen e një apartamenti banimi në shtetin grek dhe që dihet që zënë një peshë të madhe në shpenzimet e jetesës.

1.8.xviii Kjo gjë i ka mundësuar kursime më të mëdha gjatë kësaj periudhe dhe si rezultat dhe mundësi më të madhe huadhënieje.

1.8.xix Komisioni, në raportin e tij, e pranon indirekt bazueshmërinë e argumenteve të mësipërme, kur më pas, në lidhje me mundësinë financiare të shtetasit A. M. për huan e vitit 2007, merr për bazë pagat e tij pas dhënies së huas së mëparshme (të dytë). Komisioni llogarit pagat nga prilli i vitit 2004 deri në vitin 2007.

1.8.xx Subjekti, në lidhje me konstatimin tjetër të Komisionit se *mungon dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua, bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë*, ka pretenduar se nuk qëndron, duke sqaruar se në analizë të fundit, në çdo rast kur punëmarrësi nuk ka mundësi të paraqesë dokumentacion për provimin e pagimit të detyrimeve tatimore lidhur me marrëdhëniet e tij të punësimit, duhet pasur parasysh se sipas ligjit detyrimin për të paguar detyrimet e ka pasur dhe e ka punëdhënësi.

1.8.xxi Sipas legjisllacionit shqiptar, në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 10 “Mbledhja e tatimit”, është përcaktuar qartë së çdo punëdhënësi që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në germën “a”, të nenit 8, të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 9, të këtij ligji, dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.

1.8.xxii Logjikisht edhe në legjislacionin grek ky ligj duhet të ekzistojë dhe duhet të ketë të njëjtin kuptim dhe përmbajtje sikurse në legjislacionin shqiptar. Kështu, i punësuar nuk mund të mbajë përgjegjësi në rast se punëdhënësi nuk ka derdhur në organet tatimore detyrimin për të ardhurat mbi paga e shpërblime, të cilën ia ka zbritur nga paga të punësuarit. Për të ardhurat e përfituara nga puna, tatimi mbahet në burim nga punëdhënësi, sidomos kur janë krijuar jashtë shtetit dhe në shuma që janë afër pragut minimal të pagës mujore minimale që përjashtohet nga taksat dhe tatimet dhe nuk është në përgjegjësinë e të punësuarit. Në këto kushte, në çdo rast, të ardhurat nga punësimi i shtetasit A. M. janë të ardhura të ligjshme.

1.8.xxiii Subjekti ka pretenduar gjithashtu për një periudhë të largët të sigurimit të të ardhurave, ka cilësuar informalitetin dhe situatën konkrete të emigracionit në ato vite, mungesën e burimeve legale të pagesës dhe të pataknuara në Shqipëri, punësimin në emigracion të padokumentuar, për të cilët është shprehur se nuk duhet të rëndojë mbi punëmarrësin, por mbi punëdhënësin.

1.8.xxiv Duke vlerësuar të gjitha përpjekjet e bëra prej subjektit për sigurimin e provave, ku ka arritur të sigurojë një pjesë të tyre për punësimin në Greqi të shtetasit A. M. dhe duke pasur parasysh edhe faktin se ka kaluar një periudhë kohore shumë e gjatë, sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumente që justifikojnë të ardhurat e shtetasit A. M. në emigracion.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.8.xxv Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, hetimit të kryer, deklarimeve të subjektit, si dhe parashtrimeve të tij në rezultatet e dërguara, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka bërë shpjegime dhe ka dhënë detaje mbi punësimin e huadhënësit, të cilat përsëri kanë mbetur në nivel deklarativ dhe jo provueshmërie, sipas kërkesave të pikës 3, të nenit D, të Kushtetutës, ku citohet shprehimisht: *“...pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”*. Në këtë kontekst, vërehet se subjekti, megjithëse ka bërë përpjekje për të sjellë prova indirekte që të provonin punësimin e huadhënësit nga janar 1998 – maj 2001, si mekanik në tragetin “***” të shoqërisë greke që kryente linjën e udhëtarëve Korfuz-Sarandë, përsëri ka sqaruar dhe i ka qëndruar provave që kishte depozituar gjatë hetimit administrativ, mbi të cilat Komisioni arriti në konstatimet e tij paraprake.

1.8.xxvi Është fakt që subjekti ka deklaruar marrjet e huave në kohë reale, si dhe ka deklaruar edhe shlyerjet e tyre, veprime këto të cilat janë shoqëruar edhe me dokumentet provuese të kohës, por kjo nuk është e mjaftueshme për të përmbushur në mënyrë kumulative kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, sipas parashikimit ligjor se: *“...pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar tatimet.”*

1.8.xxvii Pikërisht deklaratimet të cilat kanë mbartur në vetvete lëvizje parash, duhet të realizohen mbi baza ligjshmërie, pra, duhet të provohej ligjshmëria e parasë së qarkulluar.

1.8.xxviii Lidhur me qëndrimin e subjektit se detyrimi i pagimit tatimor është përgjegjësi e punëdhënësit, pavarësisht se nga njëra anë trupi gjykues çmon se nuk ka një dispozitë kushtëzuese apo përjashtuese të ligjit nr. 84/2016, për identifikimin e subjektit përgjegjës për pagimin e detyrimeve tatimore, në rastin konkret, analizuar edhe në drejtim të ligjshmërisë së përfitimit të tyre, vlerëson se duhet të mbahet në konsideratë fakti se subjekti i rivlerësimit paraprakisht ka dështuar të provojë marrëdhënien e punësimit, duke mos depozituar për rastin

në fjalë një kontratë punësimi²⁰, listëpagesa, apo çdo dokument tjetër që provon se realisht i ka marrë këto të ardhura. Në këtë arsyetim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur kushtet ligjore të pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nga ku parashikohet: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të duhet të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaramëve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*”.

1.8.xxix Në përfundimin e mësipërm, trupi gjykues, arriti pas analizimit të provave të paraqitura nga subjekti. Në këtë drejtim, trupi gjykues mbi deklaramet e subjektit, se huadhënësi ka punuar në periudhën janar 1998 – maj 2001 në tragetin “****”, që ka kryer linjën Korfuz-Sarandë, të provuara sipas subjektit me deklaramet noteriale të kapitenit të tragetit dhe marinarëve (G. M., S. Z., I. T.), arriti në konkluzionin se lloji i provës është i njëanshëm. Sipas deklaramet provohet punësimi i huadhënësit dhe njëkohësisht deklaruesit deklarojnë edhe pagën që ai ka marrë. Pikërisht, njëanshmëria në deklarim është një alternativë që pretendohet për t’u pranuar, për sa kohë nuk ka një kontratë punësimi e cila do të qartësonte marrëdhënien e punësimit, kohën e punësimit, e plotë, e pjesshme, vitet e punësimit, si dhe do të përcaktonte pagën në favor të punëmarrësit dhe detyrimet tatimore. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se deklaramet e lëshuara nuk konkurrojnë në raport me kontratën e punësimit. Megjithatë, trupi gjykues, nëse i referohet pikërisht dokumentacionit të depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, konstaton se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2019, konfirmon regjistrimin e mjetit lundrues për transport pasagjerësh, e shënuar “****”, ka pasqyruar destinacionin e udhëtimit të këtij mjeti Sarandë - Korfuz për vitet 1997 – 2001, ka pasqyruar prekjet e këtij mjeti në port, frekuencat e tyre, si dhe ka identifikuar kapitenët e tyre, ndër të cilët identifikohet edhe shtetasi G. M., i cili ka lëshuar edhe deklaraten noteriale në favor të punësimit të huadhënësit.

1.8.xxx Trupi gjykues, në analizë të këtij dokumenti, nuk konstaton as edhe indirekt punësimin e huadhënësit.

1.8.xxxi Duke iu referuar gjithnjë dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues ka konstatuar se huadhënësi ka pasur pasaportë lundrimi, lejedalje në breg me specialitetin “marinar”, sikurse edhe shtetasit të cilët kanë lëshuar deklaraten noteriale, ku ndër ta është edhe shtetasi G. M., në pozicionin “kapiten”. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se ndryshe nga sa konfirmohen në pasaportat e lundrimit, në mënyrë të vazhdueshme vit pas viti, imbarkimet dhe zbarkimet, datat, vendet, etj., për shtetasit G. M., I. T. dhe S. Gj., të cilët kanë deklaruar punësimet e tyre, të ardhurat e përfituara, si dhe faktin se me ta ka punuar edhe shtetasi A. M., për këtë të fundit, nga verifikimi i pasaportës së lundrimit, pasqyrohet vetëm një imbarkim.

1.8.xxxii Fakti që dokumentacioni i depozituar pasqyron që ka pasur një *lejedalje në breg* apo një *pasaportë detari*, apo atë të lundrimit, nuk do të thotë që domosdoshmërisht provohet marrëdhënia e punësimit dhe, për pasojë, të ardhurat e përfituara. Trupi gjykues çmon se marrëdhënia kontraktore²¹ e punësimit ka qenë domosdoshmëri për huadhënësin, për më tepër, kur pretendohet për punësime dhe lëvizje të cilat kanë kaluar territorin e vendit të origjinës, duke prekur tokën e një shteti tjetër, që nënkupton se punësimi në një mjet që udhëton përtej vendit dhe prek një vend tjetër, apo edhe anasjellas, legjitimohet dhe është lehtësisht i

²⁰Referoju paragrafit III, të pikës 40, të vendimit nr. 1, datë 31.1.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

²¹Megjithëse Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë i miratuar me ligjin nr. 9251, datë 9.7.2004, daton pas punësimit të shtetasit A. M., deklaruar nga subjekti, përmbajtja e tij në dispozita të veçanta si p.sh., parashikimet e bëra në nenet 116, 117, 118, 119, 124/3, por edhe në tërësi, prezantojnë rëndësinë e dokumentacionit justifikues për të provuar marrëdhënien e punësimit për këtë lloj veprimtarie.

verifikueshëm përmes kësaj marrëdhënieje kontraktore ku identifikohet punëdhënësi dhe punëmarrësi.

1.8.xxxiii Nën këtë arsytim nuk gjen vend pretendimi i subjektit se edhe nëse Komisioni nuk mund të marrë për bazë pagën prej 150.000 drahmi në muaj, të konfirmuar nga dëshmitarët, atëherë t'i referohet pagës minimale mujore sipas Institutit të Statistikave të shtetit grek, përderisa vërtetohet plotësisht me dokumente zyrtare të lëshuara nga autoritetet greke dhe shqiptare se shtetasi A. M. ka punuar marinar (duke kryer detyrën e mekanikut) në tragetin “***”, pretendim i cili nuk qëndron, për faktin se marrëdhëniet e punësimit provohen dhe janë të ndërthurura me njëra-tjetrën. Nëse konsiderohen të dhënat statistikore, indirekt pranohet se dokumentacioni i depozituar ka prodhuar marrëdhënie punësimi, por mbetet e pamundur të provohet vlera e të ardhurave të përfituara. Një arsytim i tillë nuk është i pranushëm nga trupi gjykues, për sa kohë kemi të bëjmë edhe me një punësim të pretenduar jo në kushtet e emigracionit, për të cilin përsëri mbizotëron përmbushja e kërkesës ligjore për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave.

1.8.xxxiv Trupi gjykues çmon se nuk qëndron edhe pretendimi tjetër i subjektit se në çdo rast kur punëmarrësi nuk ka mundësi të paraqesë dokumentacion për provimin e pagimit të detyrimeve tatimore lidhur me marrëdhëniet e tij të punësimit, duhet pasur parasysh se sipas ligjit detyrimin për të paguar detyrimet e ka pasur dhe e ka punëdhënësi, pasi në asnjë rast subjekti nuk mundi të identifikojë marrëdhënien e huadhënësit me punëdhënësin.

1.8.xxxv Po ashtu, trupi gjykues çmon se për vetë punësimin e pretenduar, mënyrën se si ai realizohet, nuk mund të qëndrojë pretendimi i subjektit se provueshmëria i përket një periudhe të largët të sigurimit të të ardhurave, apo të qëndrojë pretendimi i informalitetit, situatës konkrete të emigracionit në ato vite, mungesës së burimeve legale të pagesës dhe të pataknuara në Shqipëri, punësimit në emigracion të padokumentuar, për të cilët është shprehur se nuk duhet të rëndojë mbi punëmarrësin, por mbi punëdhënësin. Konstatohet se huadhënësi nuk është pjesë e asnjërës prej pretendimeve të subjektit. Ai ka pasur dokumente, siç u sipërcituan, pra, pasaportë, leje, etj., por nuk ka provuar punësimin ligjor, pasi pikërisht përdorimi i tyre ka në bazë këtë lloj punësimi.

1.8.xxxvi Megjithëse subjekti pretendon se ndodhej në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumente që të justifikonin të ardhurat e shtetasit A. M., trupi gjykues vlerëson nga njëra anë jo vetëm që ky pretendim nuk u provua, pasi nuk u vërtetua përmbushja e kushteve ligjore që kërkon pika 2, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, por nga ana tjetër nuk i çmon arsyet e paraqitura si shkaqe të arsyeshme për vetë faktet e konstatuara, të lidhura me provueshmërinë e marrëdhënies së punësimit, pa u provuar kështu burimi i ligjshëm i shumës së dhënë hua.

Në të tilla kushte, trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës, dhe pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të huas në shumën 2.000.000 lekë, të marrë shtetasit A. M. .

g. Të ardhura nga kurset e bashkëshortes

1.9 Komisioni hetoi në lidhje me këto të ardhura, nga ku konstatoi fillimisht se subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 të ardhura nga kurset e realizuara nga bashkëshortja në muajt janar – mars 2004, në shumën 140.000 lekë.

1.9.i Ndërsa, në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar të ardhura nga kurset e matematikës së bashkëshortes (vitet 1997 – 2004), në shumën 850.000 lekë.

1.9.ii Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën për vitin 2003 të ardhurat e përfituara nga kurset e mësimdhënies nga bashkëshortja e tij.

1.9.iii Subjekti është pyetur²² lidhur me ligjshmërinë e tyre dhe për këtë ka depozituar dokumentacionin²³ përkatës.

1.9.iv Nga dokumentacioni i depozituar dhe praktika e ndjekur, vihet re se bashkëshortja e subjektit i ka deklaruar të ardhurat e periudhës 1997 – 2004 në formularin DIVA, të vitit 2017 dhe për këto të ardhura ka paguar në gusht të vitit 2018 tatimin në burim në masën 15 %, në shumën 127.500 lekë. Për sa më sipër, subjektit iu la barra e provës²⁴, pasi dukej se kishte mungesë dokumentacioni justifikues për përfitimin e të ardhurave nga bashkëshortja, gjatë viteve 1997 – 2004, në shumën 850.000 lekë, të deklaruara në deklaratën “Vetting”, se dukej se detyrimet tatimore për këto të ardhura ishin paguar pas dorëzimit të deklaratës “Vetting” nga subjekti dhe se dukej se subjekti kishte kryer deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën për vitin 2003 mbi përfitimin e të ardhurave nga kurset e mësimdhënies së bashkëshortes.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.9.v Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka synuar të analizojë në kuadrin ligjor dhe nënligjor konstatimet e Komisionit, referuar kryesisht ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, lidhur me mbajtjen në burim të tatimit mbi të ardhurat dhe më tej edhe ndryshimeve të tij me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013, duke pretenduar se deri në datën e këtij ligji nuk ka pasur formularë për të bërë pagesën, pasi tatimi në burim nuk mund të paguhej pa formular. Po ashtu, subjekti ka parashtruar se edhe në referencë të Udhëzimit të Ministrisë së Financave, në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, deri me ndryshimet e vitit 2014, nuk është përcaktuar mënyra e pagesës të tatimit në burim nga individët për të ardhurat, sipas nenit 33, të ligjit nr. 8438/1998. Subjekti ka theksuar se pagesa e tatimit në burim për të ardhurat nga individët (kurse mësimore, etj.) nuk mund të bëhej pa plotësuar formularin e pagesës së tatimit në burim.

1.9.vi Kërkesat ligjore kanë parashikuar që tatimi në burim të evidentohet nga personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe nga çdo person tjetër i njohur si i tillë nga legjislacioni në fuqi, nëpërmjet regjistrimeve në librat përkatës të evidentimit, të cilët përmbajnë të dhëna të plota identifikuese për subjektin përfitues. Sipas kësaj kërkesë, mënyra e mbajtjes dhe derdhjes së tatimit në burim bëhej vetëm kur njëri prej personave rezident që bën pagesën ose përfituesi i të ardhurave është i regjistruar në organet tatimore, ose është një nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, ndërsa për

²²Pyetësor nr. 2, datë 18.12.2019, së bashku me dokumentacionin shoqërues.

²³Deklaratë individuale vjetore e të ardhurave për shumën 850.000 lekë, datë 13.8.2018; urdhërpagesë tatimi mbi të ardhurat individuale në shumën 142.932 (njëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë, datë 14.8.2018; mandatpagese për shumën 142.932 (njëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë, datë 14.8.2018, i “Raiffeisen Bank”; njoftim/sqarim me shkrim datë 1.9.2018, drejtuar ILDKPKI-së, bashkë me lajmërimin e marrjes dhe dëftesën e pranimit të Postës Shqiptare sh.a., që vërtetojnë dërgimin e shkresës në ILDKPKI; kërkesë e bashkëshortes S. M., drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, datë 12.4.2019, për verifikimin e shumës së tatimeve për të ardhurat e realizuara nga kurset private të matematikës për periudhën 1997 – mars 2004; shkresë (kthim-përgjigje) nr. *** prot., datë 9.5.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, bashkëngjitur kërkesa e bashkëshortes S. M., e protokolluar me nr. *** prot., datë 17.4.2019, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Sarandë.

²⁴Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

marrëdhëniet midis individëve për të ardhura të tjera nuk kishte parashikuar asnjë mënyrë evidentimi dhe pagesë të tatimit në burim.

1.9.vii Mënyra e pagesës, është shprehur subjekti, nëpërmjet formularit të pagesës së tatimit në burim është bërë vetëm me ndryshimet e pasqyruara me Udhëzimin nr. 31, datë 29.12.2014, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

1.9.viii Duke iu referuar ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 “përkufizim”, pika 19, termi “të ardhura të ligjshme” ka këtë kuptim: *“19. ‘Të ardhura të ligjshme’ janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin ‘Mbi tatimin mbi të ardhurat’.”*

1.9.ix Siç shihet, edhe ligji nr. 84/2016, termi “të ardhura të ligjshme” i është referuar përcaktimeve të burimit të të ardhurave të parashikuara në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”. Kështu që në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave në zbatim të këtij ligji, të ardhurat e deklaruara nga subjekti si subjekt i rivlerësimit janë të ardhura të ligjshme.

1.9.x Në lidhje me pagesën e tatimit në burim, pavarësisht kohës se kur është paguar detyrimi, është paguar, dhe në asnjë kërkesë të ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nuk është shprehur se të ardhura të paligjshme do të konsiderohen ato të ardhura që detyrimet tatimore u paguhen me vonesë.

1.9.xi Nga ana tjetër, për efekt rivlerësimi, pika 3, e nenit D, e Aneksit të Kushtetutës dhe pika 19, e nenit 3, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk kanë parashikuar ndonjë përjashtim lidhur me kohën se kur duhet të jenë paguar detyrimet tatimore.

1.9.xii Lidhur me plotësimin e deklaratës vjetore të të ardhurave, në ligjin nr. 8438/1998, neni 13 “Deklarata individuale vjetore e të ardhurave”, pika 4, është përcaktuar: *“4. Përjashtohen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2.000.000 (dy milionë) lekë.”*

1.9.xiii Subjekti ka shpjeguar se të ardhurat janë realizuar nga kurse private, mësimdhënie të organizuara nga bashkëshortja (e diplomuar në matematikë), jashtë kohës, ambienteve dhe marrëdhënieve të saj të punës si mësuese matematike në shkollën e mesme ku punonte në qytetin e Sarandës. Lidhur me mungesën e dokumentacionit justifikues për përfitimin e të ardhurave nga bashkëshortja gjatë viteve 1997 – 2004, në shumën 850.000 lekë, e specifikuar si shumë në deklaratën për rivlerësim, subjekti nuk disponon ndonjë dokument, pasi edhe vetë natyra e shërbimit (kurse mësimore) ka qenë e një natyre të tillë që nuk ishte e parashikuar në ndonjë nga ligjet fiskale. Në të gjitha rastet, pagesat për kurset janë marrë në *cash* pa ndonjë mandatarkëtim. Këto të ardhura, në të vërtetë, janë deklaruar në deklaratat vjetore të pasurive.

1.9.xiv Shuma 140.000 lekë, e përfituar në vitin 2004, është deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2004.

1.9.xv Pjesa e mëparshme e të ardhurave nga kurset e mësimdhënies së bashkëshortes është deklaruar si pjesë e burimeve të krijimit të pasurive që janë deklaruar në deklarin e pasurisë së vitit 2003. Deklarimi i pasurisë së vitit 2003, si deklarim i parë, në fakt ishte deklarim përmbledhës për të gjitha pasuritë e mbledhura deri në vitin 2003 dhe i burimeve të tyre, si për

subjektin, edhe për bashkëshorten. Pavarësisht mosparashikimit në ligjin e kohës “Për tatimin për të ardhurat” të detyrimit për individët për këto të ardhura (siç u shpjegua më sipër), të gjitha të ardhurat që subjekti dhe bashkëshortja kishin krijuar nëpërmjet punës, ku përfshiheshin paga, shpërblimet dhe pagesat e përfituara nga kurset e mësimdhënies, në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 janë përfshirë me termat “*të ardhura nga paga ime dhe e bashkëshortes, si dhe të ardhura të kësaj të fundit të krijuara para martesë*” dhe “[*të ardhura*] nga puna e saj...” Për sa i përket të ardhurave nga kurset në vitet 1997 – 2004, bashkëshortja e subjektit i ka vetëdeklaruar në organet tatimore, sipas parashikimeve të ligjit nr.177, datë 28.12.2013 (i ndryshuar me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”) dhe Udhëzimit nr. 31, datë 29.12.2014, “Për tatimin mbi të ardhurat”, dhe ka paguar detyrimet tatimore në shumën 127.500 lekë (plus gjobat, shuma e paguar është 142.932 lekë). Madje bashkëshortja e subjektit u ka kërkuar edhe me shkresë organeve tatimore që të kryejnë verifikimet e tyre lidhur me këto të ardhura të vetëdeklaruar dhe detyrimin tatimor përkatës. Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, me shkresën nr.***prot., datë 9.5.2019, ka kthyer përgjigje përkatëse që gjithashtu subjekti e ka cituar shprehimisht:

1.9.xvi “*Si subjekt, lidhur me ligjshmerinë për këto të ardhura kam depozituar vetëm deklaratën individuale vjetore të të ardhurave datë 13.8.2018, për shumën 850.000 lekë, pasi në vitet e mëparshme bashkëshortja nuk ka pasur detyrimin ligjor të plotësimit të deklaratës individuale të të ardhurave.*”

1.9.xvii Krahas kësaj, rezulton se bashkëshortja e subjektit në vitin 2018 ka paguar më shumë detyrime tatimore sesa do të paguante në kohën e krijimit të këtyre të ardhurave. Konkretisht, është paguar 15 % e të ardhurave, ndërkohë që në periudhën 1997 – 2004 detyrimi tatimor për tatimet në burim ka qenë 10 % e të ardhurave. Në këtë drejtim, shteti praktikisht ka marrë edhe interesat e tatimit të paguar në një kohë të mëvonshme, pra, shteti nuk ka pasur asnjë humbje financiare.

1.9.xviii Gjithashtu, sipas subjektit, është e rëndësishme të mbahet parasysh se bashkëshortja shumicën e këtyre të ardhurave nga kurset e mësimdhënies e ka realizuar përpara martesës me të, si subjekt rivlerësimi.

1.9.xix Komisioni me të drejtë e ka marrë parasysh pagimin në vitin 2014 të tatimit (tatim në burim) për të ardhurat nga qiraja të marra në vitet 2004 – 2006, por nga ana tjetër, megjithëse janë të njëjtat kushte, nuk merr parasysh pagimin në vitin 2018 të tatimit për të ardhurat të krijuara në vitet 1997 – 2004 nga kurset e mësimdhënies.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.9.xx Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar për këtë çështje, deklarimeve të subjektit, legjislacionit tatimor të kohës, kërkesave ligjore të ligjit nr. 84/2016, si dhe parashtrimeve të dhëna nga subjekti në rezultatet e hetimit, konstaton se pretendimet e subjektit për të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja në shumën 850.000 lekë, nga mësimdhënia e kurseve shkollore, nuk qëndrojnë, nën arsyetimin si vijon:

1.9.xxi Fillimisht është konstatuar se në vitin 2004 subjekti ka deklaruar të ardhura të kësaj natyre vetëm në shumën 140.000 lekë. Në këto kushte presupozohet se diferenca e shumës së pretenduar i përket periudhës përpara vitit 2004, sikurse edhe subjekti ka pretenduar.

1.9.xxii Trupi gjykues, në vlerësimin e çështjes, mban në vëmendje faktin që diferenca nga shuma e pretenduar 850.000 lekë, si e krijuar për vitet 1997 – 2003, ka qenë tërësisht e mundur që të përshkruhej nga subjekti në deklaratën për vitin 2003, gjë që nuk është deklaruar.

1.9.xxiii Megjithatë, duke i qëndruar pretendimit të subjektit që në shumën e deklaruar në vitin 2003 bën pjesë edhe e ardhura nga mësimdhënia e bashkëshortes, trupi gjykues sërish konstaton se për sa kohë në deklarimin e *formularit likuiditete*, në depozitat e bashkëshortes së subjektit nuk citohet si burim krijimi edhe mësimdhënia nga kurset jashtëshkollore, atëherë pretendimi i shumës së të ardhurave nga kjo veprimtari, për këtë periudhë, mbetet tërësisht në nivel deklarativ.

1.9.xxiv Nga ana tjetër, vitet 2003 dhe 2004 janë vite të njëpasnjëshme dhe për pasojë subjekti ka pasur mundësinë të rirregullojë, thënë ndryshe, të saktësojë përfitimin e të ardhurave të pretenduara në deklaratën për vitin 2004, sikundër ka deklaruar me saktësi të ardhurat e përfituara për këtë vit, nga ky lloj punësimi.

1.9.xxv Me të drejtë subjekti pasqyron faktin e marrjes në konsideratë nga Komisioni të pagesës së tatimit me vonesë të të ardhurave nga qiraja e përfituar në vitet 2004 – 2006, konkretisht në vitin 2014, dhe nisur nga ky shembull kërkon që edhe të ardhurat nga mësimdhënia të konsiderohen të ligjshme, megjithëse tatimi për t'i legjitimuar është kryer në vitin 2018, por trupi gjykues ndër këto pretendime konstaton se nuk ndodhemi përpara të njëjtës situatë, qoftë kjo për mënyrën se si e ardhura nga qiraja është deklaruar ndër vite, apo edhe për faktin se tatimi për të është paguar përpara daljes së ligjit nr. 84/2016 dhe përpara plotësimit të deklaratës “Vetting”. Ndërsa, ka ndodhur krejtësisht ndryshe me deklarimin e të ardhurave nga mësimdhënia.

1.9.xxvi Më konkretisht, ato janë deklaruar vetëm në deklaratën “Vetting” dhe tatimi është paguar pas dorëzimit të kësaj deklarate.

1.9.xxvii Një fakt tjetër që nuk mbështet pretendimin e subjektit është vetë mënyra se si ai synon të argumentojë kryerjen e pagesës me vonesë, nën argumentin se në vitin 1998 nuk ka pasur formular për të bërë pagesën, pasi tatimi në burim nuk mund të paguhej pa formular dhe se legjislacioni pësoi ndryshime vetëm në vitet 2013 dhe 2014. Trupi gjykues, pikërisht duke i qëndruar pretendimit dhe sqarimit të bërë nga subjekti, vlerëson se ai ka pasur mundësitë të reagojë për të shlyer detyrimet tatimore, pikërisht në këto vite kur edhe legjislacioni ndryshoi, pra, qoftë në vitin 2013 apo në vitin 2014.

1.9.xxviii Trupi gjykues çmon se subjekti ka pasur të gjithë mundësinë që sikundër ka reaguuar me kujdes për të legjitimuar të ardhurat nga qiraja e banesës në qytetin e Sarandës, mund të kishte reaguuar në të njëjtën kohë edhe për të sqaruar dhe legjitimuar të ardhurat nga mësimdhënia në kurse jashtëshkollore të realizuara nga bashkëshortja.

1.9.xxix Pikërisht, pagesa e detyrimit tatimor vetëm pas plotësimit të deklaratës “Vetting”, për sa kohë ato deklarohen si burim krijimi në një pasuri dhe impaktojnë analizën financiare në përlllogaritje, vlerësohet se nuk ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, si dhe parashikimet e Udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi mosdeklarimi i tyre në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 dhe tatimet e paguara gjatë

procesit të rivlerësimit, nuk e bindin trupin gjykues për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, pasi duket qartë që kjo pagesë është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit.

1.9.xxx Trupi gjykues nuk trajton veprimin e kryer, pra, pagesën e detyrimit tatimor, si humbje apo përfitim në favor të shtetit, pasi janë organet e fushës përkatëse ato që mbikëqyrin dhe marrin masat për zbatimin e legjislacionit përkatës, por arsyeton në lidhje me faktin nëse në vitet e pretenduara është krijuar kjo e ardhur apo jo dhe këtë më së miri do ta provonte deklarimi në kohë reale, depozitimi i dokumentacionit justifikues mbi ushtrimin e veprimtarisë, si dhe veprimet financiare tatimore të kryera minimalisht përpara plotësimit të deklaratës “Vetting”.

Trupi gjykues, nën argumentet e bëra prezent më sipër, çmon se:

- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm dhe me dokumentacion ligjor, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës dhe pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 850.000 lekë, krijuar nga mësimdhënia e kurseve jashtëshkollore, nga bashkëshortja e subjektit.
- ✓ Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këto të ardhura të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie.

h. Dhuratë nga të afërmit e bashkëshortes

1.10 Komisioni hetoi lidhur me ligjshmërinë e krijimit të shumave të dhuruara bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga familjarët e saj, për faktin se ato janë deklaruar si burim krijimi i pasurisë.

1.10.i Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar dhe deklaramet e subjektit për këto të ardhura është vërejtur, si vijon:

1.10.ii Subjekti, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, në zërin likuiditete, ka deklaruar në emër të bashkëshortes, si më poshtë vijon:

- depozitë në shumën 200.000 drahmi greke në Bankën e Kursimeve Sarandë, me burim krijimi: dhuruar nga familjarët e bashkëshortes;
- depozitë në shumën 4.000 USD në “Tirana Bank”, me burim krijimi: dhuruar nga familjarët e bashkëshortes dhe nga puna e saj.

1.10.iii Ndërsa, në pyetësor²⁵ subjekti ka deklaruar se shumat e dhuruara bashkëshortes nga familjarët e saj janë si më poshtë:

- shuma 200.000 drahmi, dhuruar bashkëshortes para martese;
- shuma 1.898 USD, dhuruar bashkëshortes para martese.

1.10.iv Nga analizimi i dokumentacionit të administruar²⁶, bashkëshortja e subjektit ka hapur një depozitë në “Tirana Bank” në datën 30.1.2001, në shumën 1.898 USD, të cilën subjekti e deklaroi se është dhuruar nga familjarët e saj. Rezulton se gjatë vitit 2001 bashkëshortja ka kryer disa derdhje në këtë depozitë, duke arritur në gjendjen 6.000 USD, nga të cilat 4.102 USD të ardhura nga punësimi i saj.

1.10.v Në këtë depozitë bashkëshortja e subjektit më pas ka kryer tërheqje, e cila në fund të vitit 2003 rezulton të jetë në vlerën 4.000 USD, vit kur është kryer edhe deklarimi për herë të parë.

²⁵Pyetësor nr. 2, datë 18.12.2019.

²⁶Shkresë nr***prot., datë 28.1.2020, e “Tirana Bank”.

Komisionit, sikurse pasqyrohet edhe në tabelën më poshtë, i ka rezultuar se prindërit e bashkëshortes së subjektit nga viti 1996 kanë qenë në pension²⁷.

Viti	Të ardhura M. M.	Të ardhura K. M.	Total në lekë
1996	33,750	33,750	67,500
1997	45,000	45,000	90,000
1998	53,250	53,250	106,500
1999	58,800	58,800	ë7,600
2000	63,288	63,288	126,576
2001	70,248	70,248	140,496
	324,336	324,336	648,672

1.10.vi Siç edhe konstatohet, të ardhurat nga pensioni rezultojnë në nivel minimal për të përballuar shpenzimet e jetesës apo dhurimet e kryera (200.000 drahmi dhe 1.898 USD).

1.10.vii Ndërsa për ligjshmërinë e të ardhurave nga punësimi i vëllait, shtetasit A. M. (të cilat Komisioni i ka trajtuar në shkronjën “f” të kësaj pasurie) si pjesë e përbërjes familjare, Komisioni është shprehur më sipër për sa i përket konstatimit në rezultatet e hetimit, por edhe ecurisë më pas deri në konkluzionin përfundimtar.

1.10.viii Për sa i përket të ardhurave të bashkëshortes së subjektit nga punësimi²⁸ në vitet 1997 – 2001, ka rezultuar se ka realizuar të ardhura në shumën 555.914 lekë dhe ka deklaruar si të ardhura nga kurset për këto vite, shumën 850.000 lekë. Në lidhje me ligjshmërinë mbi të ardhurat nga kurset e mësimdhënies, Komisioni ka arsyetuar më sipër, si dhe për sa i përket konstatimit në rezultatet e hetimit, por edhe ecurisë më pas deri në konkluzionin përfundimtar.

1.10.ix Mbi këto konstatime, në rezultatet e hetimit, subjektit iu kalua barra e provës²⁹, pasi dukej se kishte mungesë dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të shumave të dhuruara (200.000 drahmi dhe 1.898 USD) bashkëshortes së subjektit nga familjarët e saj para martesë, si dhe dukej se kishte mungesë dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të derdhjeve në shumën 4.102 USD në depozitën në “Tirana Bank”, të deklaruar nga të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.10.x Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka pranuar mbi të ardhurat nga pensioni i prindërve të bashkëshortes se ato rezultojnë në nivele jo të larta, por se, sipas tij, prindërit e bashkëshortes kanë qenë të punësuar pa ndërprerje që prej viteve ‘50 e në vazhdim dhe pretendimi i mësipërm i Komisionit, i cili merr parasysh vetëm disa vite të fundit të pensionit, nuk është korrekt, pasi ata kanë pasur kursimet e tyre si çdo prind dhe sidomos prindërit shqiptarë kanë ndihmuar fëmijët duke u dhuruar qoftë *cash*, banesë, e çfarë kanë pasur mundësi. Dhe në asnjë mënyrë

²⁷Aneks 4/16 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁸Ministria e Arsimit dhe Sportit, zyra arsimore, shkresa nr. *** prot., datë 1.11.2016.

²⁹Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

nuk mund të gjykohet se meqenëse pensionet janë në nivele të ulëta, ata nuk kanë pasur mundësinë për t'i dhuruar vajzës së tyre shumën prej 200.000 dhrahmi dhe 1.898 USD.

1.10.xi Krahas kësaj, sipas deklarimeve të subjektit, me rastin e martesës së lidhur në vitin 2002 subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë organizuar ceremoni martesore (dasmë) dhe në këtë drejtim nuk kanë ngarkuar me asnjë shpenzim familjet e tyre, prandaj shumat e mësipërme të dhuruara nga familjarët e bashkëshortes janë ndihma dhe kontributi i tyre për vajzën dhe motrën që po krijonte familjen e saj.

1.10.xii Konstatimi i Komisionit se *duket se ka mungesë dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të derdhjeve në shumën 4.102 USD në depozitën në "Tirana Bank", të deklaruar nga të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit*, sipas subjektit nuk qëndron, pasi, për sa i përket dokumentacionit justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të derdhjeve në shumën 4.102 USD në depozitën në "Tirana Bank", subjekti e ka deklaruar që në deklarin e pasurisë së vitit 2003 se depozita prej 4.000 USD (datë 31.12.2003) në "Tirana Bank" e ka burimin nga dhurime të familjarëve të bashkëshortes dhe të ardhura nga puna e saj para martese (data e martesës 1.7.2002). Janë pikërisht të ardhurat nga puna e bashkëshortes ku subjekti ka pasur parasysht të ardhurat e krijuara prej saj nga pagat, shpërblimet dhe kurset e mësimdhënies, ato që kanë shërbyer për derdhjet në këtë depozitë tej shumës së dhuruar prej 1.898 USD. Subjekti sqaron se dhurimi i shumës 1.898 USD dhe derdhjet që kanë arritur në shumën 4.102 USD, për shkak të të cilave depozita në datën 31.12.2001 shkoi në rreth 6.000 USD, janë kryer të gjitha para martesës. Është pikërisht kjo depozitë që në datën 31.12.2003 ishte zvogëluar në shumën 4.000 USD, për shkak të tërheqjeve të kryera, e cila është deklaruar nga subjekti në deklarin e pasurisë së vitit 2003.

1.10.xiii Subjekti ka sqaruar se gjatë periudhës 1997 – 2001 (para martesës më 1.7.2002) bashkëshortja ka realizuar të ardhura nga pagat në shumën 555.914 lekë. Gjithashtu, bashkëshortja ka krijuar të ardhura nëpërmjet kurseve të mësimdhënies, të cilat kanë qenë të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës në fjalë. Për faktin se bashkëshortja ka jetuar gjatë gjithë periudhës 1997 – 2003, periudhë në të cilën përfshihet edhe periudha në fjalë, me familjen e saj biologjike, shpenzimet e saj për jetesë kanë qenë më të ulëta, duke i krijuar kështu mundësi reale financiare për të kryer derdhjet e shumave që figurojnë gjatë vitit 2001 në llogarinë bankare në "Tirana Bank".

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.10.xiv Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit, nuk konstaton depozitim të ndonjë dokumenti shtesë justifikues pas dërgimit të rezultateve të hetimit, me qëllim provueshmërinë e krijimit të shumave të dhuruara. Në kontekstin e arsyetimit të bërë më sipër lidhur me krijimin e të ardhurave familjare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ku përfshihen: (i) prindërit, vëllai i saj, si dhe ajo vetë; (ii) ku është argumentuar në detaje niveli i provueshmërisë së të ardhurave pikërisht të vëllait të saj; (iii) të vetë bashkëshortes së subjektit; (iv) ku ndër të tjera, subjekti rithekson si burim krijimi përsëri të ardhura nga mësimdhënia në kurset jashtëshkollore; por edhe (v) në këndvështrimin e nivelit të pensioneve të pranuar nga vetë subjekti, çmon se mbetet evident konstatimi i pamundësisë së krijimit të të ardhurave dhënë dhuratë bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Megjithatë, nisur nga fakti i shumës së dhënë hua, megjithëse është deklaruar si burim krijimi dhe pavarësisht se është krijuar përpara martesës,

- Trupi gjykues e sheh në proporcionalitet vlerësimin e kësaj të ardhure, nga ku, edhe pse ligjshmëria e shumës së dhuruar ka mbetur në nivel deklarativ, konstaton se edhe nëse shumat e dhuruara merren në konsideratë, ato janë në vlera shumë të vogla, duke mospasjellë kështu ndonjë impakt në analizën financiare të pasurisë, për shkak të balancës negative të rezultuar mbi të ardhura, pasuri dhe detyrime deri në vitin 2003.

➤ **Në lidhje me likuidimin e shumës 58.369 euro, të shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie**

1.11 Komisioni hetoi në lidhje me këtë likuidim dhe në tërësi konstatoi, si vijon:

Subjekti është pyetur³⁰ për mënyrën e likuidimit të kësaj pasurie dhe për të provuar pagesat e kryera, për të cilat ka depozituar dokumentacionin e pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 3

Data	Vlera në euro	Përshkrimi
22.7.2004	22,680	BKT, derdhje në llogari të firmës “****” për blerjen e një apartamenti
19.11.2004	14,000	Mandatarkëtim, kontratë sipërmarrjeje, kësti i II-të
4.3.2005	14,350	BKT, kërkesë transaksioni z. Ardit Mustafaj, shlyerja e këstit për blerjen e apartamentit
2005	2,522	Pagesë shtesë për pllakat, por nuk ka dokumentacion
4.11.2006	4,817	Mandatarkëtim për likuidimin përfundimtar të ap. **** + kontratat
	58,369	

1.11.i Nga hetimi ka rezultuar se në vitin 2004 nga subjekti është paguar shuma 36.680 euro; në vitin 2005 është paguar shuma 16.872 euro; dhe në vitin 2006 është paguar shuma 4.817 euro.

1.11.ii Meqenëse pagesat gjatë viteve 2004 dhe 2006 janë kryer pothuajse në fund të vitit dhe ajo e vitit 2005 ka si burim kredinë e marrë në BKT, analiza financiare është kryer vjetore.

1.11.iii Në tabelën më poshtë pasqyrohet analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitet 2004 – 2006, vite kur është kryer investimi në këtë pasuri.

Tabela nr. 4

Nr.	Përshkrimi	2004	2005	2006
1	TË ARDHURA	3,255,729	1,775,695	1,907,374
	Të ardhura nga paga e subjektit	1,071,623	1,089,380	1,136,175
	Të ardhura nga paga e bashkëshortes	262,349	516,315	541,199
	Të ardhura nga qiraja e apartamentit me sip. 54 m ² Sarandë	120,000	170,000	130,000
	Të ardhura nga shitja e objektit të papërfunduar me sip. 120 m ² dhe truall me sip. 304 m ²	1,800,000	-	-
	Dhurime nga familjarët	-	-	100,000
	Interesa bankare	1,757	-	-

³⁰Pyetësor nr. 2, datë 18.12.2019.

2	SHPENZIME	(2,022,566)	946,340	1,327,900
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	281,592	328,671	328,671
	Shpenzime arredimi ap. Sarandë	30,000	25,000	-
	Shpenzime arredimi ap. Tiranë	-	-	450,000
	Hua nga z. Gj. D.	350,000	1,010,000	340,000
	Hua nga z. A. M.		-	2,000,000
	Detyrim për “****” sh.p.k.	(2,684,158)	1,758,449	595,877
	Kredi në BKT (20.000 euro), datë 28.2.2005	-	(2,175,780)	2,560,930
	Kredi në “Raiffeisen Bank” (5.000.000 lekë), datë 18.10.2006	-	-	(4,947,579)
3	PASURI	6,256,547	320,871	80,434
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme			
	Autoveturë tip “Mercedes Benz” (datë 24.6.2004) me targa ***	530,000	-	-
	Kontratë sipërmarrje për ap.Tiranë me “****” sh.p.k (56.700 euro), datë 28.7.2004	7,186,158	309,046	-
	Ndryshim likuiditeti	(1,459,611)	11,825	80,434
	DIFERENCA (1-2-3)	- 978,253	508,483	499,040

1.11.iv Komisioni nuk ka përfshirë, në analizën financiare, të ardhurat nga kurset e mësimdhënies së bashkëshortes së subjektit, nga dhurimet e familjarëve, si dhe huaja e shtetasit A. M..

1.11.v Nga përlllogaritjet financiare të kryera, dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në vitin 2004 në shumën 978.253 lekë, për të investuar në këtë pasuri të paluajtshme, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare dhe për këtë konstatim subjektit iu kalua barra e provës³¹.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.11.vi Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka pretenduar se në analizën financiare, te rubrika “të ardhura” nuk është marrë parasysh shuma 140.000 lekë, e ardhur e krijuar nga puna e bashkëshortes (kurset e mësimdhënies), e deklaruar që në deklarin e pasurisë së vitit 2004 dhe për të cilën janë paguar detyrimet tatimore, prandaj kjo shumë duhet marrë parasysh dhe duhet të përfshihet në analizën financiare të vitit 2004.

1.11.vii Subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Komisioni, në analizën financiare, te rubrika ‘shpenzime’ si shpenzime jetese ka vendosur shumën 281.592 lekë, e llogaritur sipas ILDKPKI-së për tre persona. Deri më 22.10.2004, datë në të cilën lindi fëmija ynë i parë, ne kemi qenë familje me dy persona dhe kjo shumë në pasqyrën financiare vetëm për shkak të numrit të personave duhet të jetë në vlerën 187.928 lekë, sipas ILDKPKI-së. Gjithashtu, sqaroj se gjatë*

³¹Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

vitet 2004 (por edhe në vitet 2005 e deri afër fundit të vitit 2006) nuk kemi pasur shpenzime qiraje, energjie elektrike dhe uji, pasi unë me familjen time kam jetuar në banesën e prindërve të mi në Tiranë. Gjithashtu, edhe transporti im në funksion të punës është kryer me mjedin e transportit të institucionit (Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda), në të cilin unë kam punuar që nga data 1.1.2004. Nga Institucioni i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda janë mbuluar edhe shpenzimet e telefonit celular që në fillimet e detyrës. Prandaj, gjykoj se shpenzimet për jetesë të vitit 2004 duhet të jenë edhe më të ulëta sesa shuma e mësipërme për dy persona.

1.11.viii Nga ana e Komisionit, në analizën financiare, te rubrika 'shpenzime' nuk është marrë parasysh huaja e marrë në vitin 2004 nga kunati im A. M., në shumën (1.000.000) lekë, e deklaruar që në deklarin e pasurisë së vitit 2004, deklarin e pasurisë së vitit 2005 (si e pakthyer ende), deklarin e pasurisë së vitit 2006 (kur është likuiduar), procesverbalin e deklarin të mbajtur në ILDKPKI, në datën 13.10.2014 dhe në deklaratën për rivlerësim 2016, një detyrim ky i shlyer prej kohësh prej meje, siç është deklaruar edhe më parë në deklarinet respektive dhe në deklarin për rivlerësim të vitit 2016.

1.11.ix Huaja provohet me kontratën noteriale të huadhënies me nr. ***, datë 20.3.2006 dhe deklaratën noteriale (për likuidimin tërësisht të saj) me nr. ***, datë 31.10.2006, prandaj kjo shumë prej 1.000.000 lekësh duhet marrë parasysh dhe përfshirë në analizën financiare të vitit 2004.”

1.11.x Subjekti ka pretenduar se me saktësimet e mësipërme, rezultati i analizës financiare për vitin 2004 është pozitiv.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.11.xi Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit, vlerëson se për sa kohë është shprehur lidhur me ligjshmëritë e të ardhurave të bashkëshortes nga mësimdhënia dhe të huadhënësit A. M., pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë, dhe për pasojë këto të ardhura nuk përlllogariten në analizën financiare. Në vijim, trupi gjykues vlerëson të konsiderojë në përlllogaritjet financiare pretendimin e subjektit se deri në datën 22.10.2004 kanë qenë familje me dy persona, dhe në këtë drejtim njësia e shërbimit ligjor ka rillogaritur shpenzimet e jetesës sipas numrit të anëtarëve për 10 muaj me 2 anëtarë dhe për 2 muaj me 3 anëtarë, nga ku konstatohet se ky zë rezulton në shumën 203.372 lekë, nga 281.592 lekë pasqyruar më parë.

1.11.xii Gjithashtu, trupi gjykues, duke mbajtur në vëmendje një zë tjetër të pasqyruar në analizën financiare të vitit 2004, ku një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie kanë qenë edhe të ardhurat në shumën 1.800.000 lekë nga shitja e objektit 1+1, për të cilat Komisioni në rezultatet e hetimit dërguar subjektit, është shprehur se këto të ardhura janë përfshirë në analizën financiare deri në provueshmërinë e ligjshmërisë së shumës së shpenzuar për ndërtimin e kësaj pasurie, të ardhura të cilat më pas nuk u provuan (sikurse është arsyetuar në vijim në këtë vendimmarrje), në rillogaritjet e bëra në analizën financiare për vitin 2004 (pasqyruar në tabelën më poshtë) nga njësia e shërbimit ligjor ato nuk janë marrë në konsideratë dhe për këtë shkak, analiza financiare e vitit 2004 ka ndryshuar nga rezultati negativ prej 978.253 lekësh, në balancë negative prej 2.700.033 lekësh.

Tabela nr. 5

Nr.	Përshkrimi	2004
1	TË ARDHURA	1,455,729
	Të ardhura nga paga e subjektit	1,071,623
	Të ardhura nga paga e bashkëshortes	262,349
	Të ardhura nga qiraja e apartamentit me sip. 54 m ² , Sarandë	120,000
	Interesa bankare	1,757
2	SHPENZIME	(2,100,786)
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	203,372
	Shpenzime arredimi ap. Sarandë	30,000
	Hua nga z. Gj. D.	350,000
	Detyrim për “****” sh.p.k.	(2,684,158)
3	PASURI	6,256,547
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Autoveturë tip “Mercedes Benz” (datë 24.6.2004), me targa ***	530,000
	Kontratë sipërmarrjeje për ap. Tiranë me “****” sh.p.k. (56.700 euro) datë 28.7.2004	7,186,158
	Ndryshim likuiditeti	(1,459,611)
	DIFERENCA (1-2-3)	- 2,700,033

✓ Bazuar në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të të ardhurave në shumën 2.700.033 lekë, në vitin 2004, për të investuar në këtë pasuri të paluajtshme, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

➤ **Në lidhje me trajtimin preferencial të subjektit**

1.12.i Gjithashtu, Komisioni hetoi edhe lidhur me trajtimin preferencial në përfitimin e kësaj pasurie.

1.12.ii Në këtë drejtim, referuar të dhënave zyrtare të Entit Kombëtar të Banesave mbi kostot e shitjes, nisur nga qyteti ku është pasuria, si dhe viti kur është blerë, rezultoi se çmimi i shitjes në referencë të legjislacionit të kohës për vitin 2004 është 68.571 lekë/m².

1.12.iii Në kushte të tilla, pasuria e subjektit me sip. 126 m² e përlllogaritur me çmimin 68.571 lekë/m² rezulton në vlerën 8.639.946 lekë, ndërkohë që subjekti e ka blerë këtë pasuri në vlerën 6.900.000 lekë.

1.12.iv Nga hetimi u konstatua një diferencë prej 1.739.946 lekësh (rreth 20 % më lirë nga çmimet e tregut të asaj kohe, sipas Entit Kombëtar të Banesave).

1.12.v Mbi këtë konstatim, subjekti iu kalua barra e provës,³² pasi dukej se kishte mungesë dokumentacioni provues për të argumentuar trajtimin në dukje preferencial, për sa i përket çmimit të shpenzuar për blerjen e pasurisë, në krahasim me kostot e shitjes së Entit Kombëtar

³²Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

të Banesave apo me blerës të tjerë në të njëjtën pasuri referuar të njëjtës kohë të porositjes, apo blerjes së pasurisë.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.12.vi Subjekti, lidhur me këtë problematikë të konstatuar, në parashtrime ka sqaruar se kontrata e sipërmarrjes është lidhur kur pallati ishte ende në fillimet e ndërtimit dhe kur nuk ishte zhvilluar ende as infrastruktura e zonës nga Bashkia Tiranë.

1.12.vii Në këtë situatë, çmimet kanë ndryshuar (në rritje) me kalimin e kohës, me avancimin e punimeve të pallatit dhe me zhvillimin e infrastrukturës së zonës nga Bashkia, gjë që ka rritur më tepër vlerën e pronave në këtë zonë. Subjekti ka kërkuar që Komisioni t'i referohet pamjeve satelitore të *Google Earth* nga viti 2003 e në vazhdim, në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës në zonën ku ndodhet pallati.

1.12.viii Subjekti, gjithashtu, ka sqaruar se nuk ka pasur asnjë trajtim preferencial për sa i përket çmimit të blerjes së apartamentit në Tiranë dhe se me të njëjtin çmim prej 450 euro/m², madje edhe më të ulët, janë lidhur edhe kontrata të tjera sipërmarrjeje në të njëjtën periudhë për apartamente në të njëjtin pallat. Subjekti ka depozituar pesë kontrata³³ të ngjashme.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.12.ix Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të subjektit dhe pas analizimit të kontratave të depozituara, ka konstatuar se në të njëjtat kushte, sikurse është trajtuar subjekti i rivlerësimit sa i përket shumës së shpenzuar për blerjen e pasurisë janë trajtuar edhe të tjerë banorë.

- ✓ Në kushte të tilla, trupi gjykues konkludon se është deklaruar me vërtetësi vlera e deklaruar për blerjen e kësaj pasurie dhe se nuk gjen bazueshmëri si trajtim preferencial në favor të subjektit.

➤ Në lidhje me ekzistencën e konfliktit të interesit me huadhënësin

1.13 Komisioni ka hetuar në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi (shqyrtimin e ndonjë çështjeje gjyqësore) midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtimore “***”, ku subjekti ka blerë këtë pasuri apo shtetasve R. Z. B. si përfaqësues i shoqërisë dhe A. M. në cilësinë e huadhënësit.

1.13.i Nga korrespondenca³⁴ e mbajtur me institucionet punëdhënëse të subjektit nuk është konfirmuar shqyrtimi i ndonjë procesi gjyqësor në favor të subjektit dhe personave për të cilët u ushtrua hetimi.

1.13.ii Po ashtu, Komisioni ka pyetur³⁵ edhe subjektin e rivlerësimit, i cili ka cituar shprehimisht: “*Nuk kam shqyrtuar apo përfunduar asnjë çështje gjyqësore me shtetasit ..., A. M., ..., ..., shoqërinë ‘***’ sh.p.k. dhe me shtetasin R. Z. B., si individ apo administrator*”.

- ✓ Në këto kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ekzistencën e ndonjë konflikti interesi me rethin e personave që kanë ndikuar në përfitimin e kësaj pasurie, qofshin në cilësinë e

³³Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 3.2.2004, për ndërtim apartamenti, ku çmimi i apartamentit është 450 euro/m²; kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 6.2.2004, për ndërtim apartamenti, ku çmimi i apartamentit është 450 euro/m²; kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 19.2.2004, për ndërtim apartamenti, ku çmimi i apartamentit është 450 euro/m²; kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 13.4.2004, për ndërtim apartamenti, ku çmimi i apartamentit është 450 euro/m²; kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 22.4.2004, për ndërtim apartamenti, ku çmimi i apartamentit është 432 euro/m².

³⁴Shkresë, datë 30.12.2019, e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

³⁵Referoju pyetësorit nr. 2, datë 18.12.2019, në dosjen e Komisionit.

huadhënësve apo kryesisht me shoqërinë ndërtimore dhe/ose me përfaqësuesin në cilësinë e administratorit, por as edhe si një individ pa pasur këtë tagër.

➤ **Në lidhje me ndërtimin e objektit 1+1 në Sarandë, në vitin 2003, përshkruar në germën “e” të pasurisë nr. 1**

1.14 Komisioni ka hetuar dhe analizuar në vijim mënyrën e krijimit të kësaj pasurie për shkak se:

- është ndërtuar përgjatë kohës që subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e gjyqtarit në Sarandë;
- për ndërtimin e objektit janë marrë hua, të cilat sikurse u theksua më sipër arsyetohen në këtë vendimmarrje;
- kredia e përfituar me kushte lehtësuese është përdorur edhe për shlyerjen e huave të marra, si dhe për shkak se të ardhurat e gjeneruara nga shitja e objektit janë përdorur për blerjen e kësaj pasurie, deklaruar në deklaratën “Vetting”.

1.14.i Pra, Komisioni verifikoi një sërë faktorësh të gërshetuar me njeri-tjetrin, të cilët diktuan zgjerimin³⁶ e hetimit administrativ në vlerësimin e vërtetësisë së deklarimeve të subjektit në raport me provat e administruara për ndërtimin e objektit në vitin 2003, në Sarandë, deklaruar i papërfunduar, si dhe për ligjshmërinë e burimit të krijimit.

1.14.ii Në këtë drejtim, nga verifikimi i dokumentacionit³⁷ që i përket kësaj pasurie/objekt i papërfunduar, të administruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, por edhe nga dokumentacioni i administruar në ILDKPKI³⁸, Komisionit i ka rezultuar se:

- fillimisht subjekti ka blerë tokën me sip. 304 m², në vlerën 145.920 lekë, nga seksioni i financës në Bashkinë Sarandë;
- më tej, me vendimin nr. 1, datë 28.8.1999, të Bashkisë Sarandë është miratuar edhe numri dhe funksionimi i kateve të ndërtimit mbi tokë (2);
- sipas vërtetimit hipotekor të depozituar nga subjekti, dokument i lëshuar nga ZVRPP-ja Sarandë, në datën 15.12.2003, banesa cilësohet me numër katesh 1+1, me sip. ndërtimi 120 m²;
- në aktin e kolaudimit datë 20.10.2003, cilësohet: “...objekti është ndërtuar konform projektit me numër katesh tri + garazh; kati nëntokë ka sip. 120 m² dhe shërben për funksionin garazh; kati i parë ka sip. 120 m² dhe shërben për funksionin lokal; kati i dytë ka sip. 120 m² dhe shërben për funksionin banesë, si dhe kati i tretë ka sip. 120 m² dhe shërben për funksionin banesë.”;
- në këtë akt është pasqyruar se ky i fundit, është përgatitur në praninë edhe të investitorit, që nisur nga i gjithë dokumentacioni rezultoi të ishte vetë subjekti i rivlerësimit.

1.14.iii Për shkak të mospërputhjes së të dhënave në aktet e lartpërmendura, subjekti është pyetur lidhur me: (i) numrin e kateve të kësaj pasurie; (ii) sipërfaqen e secilit kat; (iii) kohën e ndërtimit dhe përfundimit; (iv) shpenzimet e kryera, etj., nga ku ka deklaruar se: “Objekti ka qenë i papërfunduar, siç kam deklaruar edhe në deklarinimin e pasurisë së vitit 2003 dhe në këtë gjendje është shitur. Në vitin 2003, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

³⁶Gjithashtu, sa i takon vlerësimin të pasurive të sipërcituara, objekti i kontrollit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, shtrihet edhe ndaj pasurive të fituara para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, për sa kohë kriteri i kontrollit të pasurive nuk kufizohet apo kushtëzohet nga momenti i fillimit të detyrës së subjektit apo nga përcaktimi i periudhës së vlerësimit, si në rastin e kriterit të aftësive profesionale (neni 41/3, i ligjit nr. 84/2016).

³⁷Depozituar në përgjigje të pyetjes nr. 9, në pyetësorin nr. 2, datë 18.12.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁸Aneks nr. 29, në dosjen e ILDKPKI-së.

Sarandë (ZVRPP Sarandë) është regjistruar aq sa ka qenë në fakt, sipas verifikimit të kryer në vend edhe nga ZVRPP-ja Sarandë. Këto rrethana janë sqaruar prej meje edhe në vitin 2005 në ILDKPKI, ku në datën 15.11.2005 kam paraqitur në ILDKPKI edhe sqarimin me shkrim nga ZVRPP-ja Sarandë, të datës 7.11.2005, në të cilin thuhet: '... për sa i takon katit të dytë dhe të tretë sipas lejes nuk janë ndërtuar dhe nuk janë regjistruar në këtë zyrë. 'Bashkëngjitur sqarimit është paraqitur nga ZVRPP-ja Sarandë edhe kopja e fletës përkatëse të aktit të kolaudimit, me shënimin e bërë nga ZVRPP-ja Sarandë, në faqen e dytë të aktit të kolaudimit në lidhje me numrin faktik të kateve të ndërtuara dhe sqarimin se kati i dytë dhe i tretë nuk ishin ndërtuar.

1.14.iv *Sqaroj se emërtimet e funksioneve të kateve në aktin e kolaudimit (për pjesën që ishte ndërtuar në fakt, siç u përmend më lart) janë bërë thjesht sipas emërtimeve të tyre në projekt, pasi as nuk kanë qenë të banueshme dhe as nuk janë vënë në funksion ndonjëherë prej meje, sepse edhe ndërtimi faktik 1+1, që u regjistrua ka qenë i papërfunduar edhe në fazën e karabinasë.*

1.14.v *Lapsusi i lejuar në aktin e kolaudimit datë 20.10.2003 nuk ka sjellë asnjë pasojë në regjistrim dhe në fitimin e pronësisë nga ana ime, për shkak se edhe me kërkesën time, ndërtimi është verifikuar në vend nga ZVRPP-ja Sarandë dhe është regjistruar sipas gjendjes faktike.*

1.14.vi *Lidhur me sa më sipër dëshiroj të sqaroj gjithashtu, se me sa jam në dijeni, kohë më vonë, personi që bleu objektin e papapërfunduar e vazhdoi ndërtimin, duke bërë ndryshime, shtesa anësore dhe shtesa katesh (ndërtoi edhe katet e tjera), të cilat i ka legalizuar më pas në vitin 2017 pranë ALUIZNI-t, sipas ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, 'Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje' (për shkak se ndërtoi pa leje). Nga ana ime nuk është bërë ndërtim tej objektit të papërfunduar 1+1, të regjistruar në ZVRPP Sarandë, në vitin 2003. Në lidhje me investitorin, sipërmarrësin etj., sqaroj se investitor kam qenë unë, sipërmarrës inxhinier D. B./'***' sh.p.k., si dhe kolaudator inxhinier Dh. L. .*

1.14.vii *Ndërtimi i objektit, për aq sa është ndërtuar nga ana ime, është kryer në periudhën korrik – tetor të vitit 2003”.*

Subjekti ka depozituar:

- me shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2020, të DVASHK Sarandë, dokumentacionin e regjistrimit në vitin 2003 të kësaj prone;
- vërtetim, datë 15.11.2005, i lëshuar nga ILDKPKI-ja (për dorëzimin nga subjekti në ILDKPKI të shkresës sqaruese datë 7.11.2005, të ZVRPP-së Sarandë, së bashku me faqen e dytë të aktit të kolaudimit, datë 20.10.2003).
- shkresën sqaruese, datë 7.11.2005, të ZVRPP-së Sarandë, së bashku me faqen e dytë të aktit të kolaudimit datë 20.10.2003, ku figuron shënimi i bërë nga ZVRPP-ja në lidhje me katet e ngritura dhe të pangritura.

1.14.viii *Komisioni, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar për këtë pasuri, ka konstatuar pasqyrimin e disa fakteve, si vijon:*

i) Vërtetimi³⁹ hipotekor i ZVRPP-së Sarandë, lëshuar në datën 25.3.2004, konfirmon pasurinë 1+1 në favor të subjektit të rivlerësimit, me përshkrimin “objekt banese me nr. katesh 1+1...me sip. ndërtimi 120 m² dhe sip. trualli që zë dhe në funksion prej 304 m²”.

ii) Në kontratën e shitjes së kësaj pasurie, nr. ***, datë 28.3.2004 nuk konfirmohet se objekti që shitej (1+1) ishte i papërfunduar.

iii) Vërtetimi⁴⁰ hipotekor lëshuar nga ZVRPP-ja Sarandë, pas shitjes⁴¹ së pasurisë, shtetasi P. G., konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie me përshkrimin⁴² “objekt banese me nr. katesh 1+1, me sip. ndërtimi 120 m² dhe sip. trualli që zë dhe në funksion prej 304 m², kati nëntokë shërben për funksion garazh, kati i parë shërben si lokal”.

iv) Shkresa e ZVRPP-së Sarandë, datë 7.11.2005, në përmbajtje, ndër të tjera konfirmon ekzaktësisht se “ka përfunduar kati i parë nëntokë dhe shërben si garazh, si dhe kati i parë i kësaj godine me sip. 120 m²”.

v) Në vendimin nr. 1, datë 28.8.1999, të miratuar nga Bashkia Sarandë, citohet se numri i kateve mbi tokë është (2).

1.14.ix Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion për të provuar shpenzimet e kryera në shumën 1.800.000 lekë për këtë objekt, sikurse ka deklaruar.

1.14.x Komisioni, në analizë të fakteve të konstatuara, ka arritur paraprakisht në konkluzionin se ndërtimi 1+1 ka qenë i përfunduar dhe se në kushtet kur subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion vlerën e shpenzimit të kryer për ndërtimin, Komisioni, në kryerjen e analizës financiare (shihni më poshtë tabelën nr. 6) i është referuar kostove të ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave.

1.14.xi Në vijim të hetimit, lidhur me burimin e krijimit të objektit është konstatuar se subjekti në deklaratën për vitin 2003 ka deklaruar:

- hua nga shtetasi Gj. D.;
- hua nga shtetasi A. M., në shumën 1.000.000 lekë;
- të ardhura nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes.

1.14.xii Duke qenë se huaja e marrë nga shtetasi Gj. D. është deklaruar se është përdorur pjesërisht për këtë pasuri dhe kryesisht për apartamentin e blerë në Sarandë, Komisioni e ka pasqyruar në mënyrë të hollësishme hetimin për të, në pasurinë e renditur me nr. 4, për shkak edhe të problematikës që ka rezultuar në tërësi, për pamundësinë e provueshmërisë së krijimit të shumës së dhënë hua.

1.14.xiii Njëkohësisht edhe sa i takon huas së dhënë nga shtetasi A. M. (përkatësisht vëllai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit) në shumën 1.000.000 lekë, Komisioni ka arsyetuar më sipër për shkak se, sikurse është përmendur, nga ky shtetas subjekti ka marrë hua në shumën 2.000.000 lekë deri në vitin 2004, respektivisht të deklaruara si të përdorura: vlerën 1.000.000

³⁹Referoju vërtetimit hipotekor me datë lëshimi 25.3.2004, depozituar në dokumentacionin e ASHK Drejtoria Vendore Sarandë.

⁴⁰Akti është i administruar në dokumentacionin bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 4.2.2020, të ASHK Drejtoria Vendore Sarandë, në dosjen e Komisionit.

⁴¹Nga dokumentacioni bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 4.2.2020, të ASHK Drejtoria Vendore Sarandë, konfirmohet se pas shitjes, pasuria është shtuar me shtesë anësore dhe në lartësi 5 kate, e regjistruar nga blerësi, bazuar në lejen e legalizimit nr. ***, datë 19.12.2017. Sipas të dhënave të pasqyruara po në këtë dokumentacion rezulton se funksionimi i kateve të pasurisë është i njëjtë me atë të përshkruar në aktin e kolaudimit.

⁴²Referoju vërtetimit hipotekor me datë lëshimi 20.4.2004, depozituar në dokumentacionin e ASHK Drejtoria Vendore Sarandë.

lekë në ndërtimin e objektit, si dhe vlerën 1.000.000 lekë për shlyerjen e kësteve të pasurisë nr.1. Edhe në këtë rast, burimi i krijimit të shumës 2.000.000 lekë, hetuar dhe analizuar më sipër, mbeti në nivel deklarativ dhe jo në nivel provueshmërie, pasi subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë aftësinë paguese nga huadhënësi, shtetasi A. M. .

1.14.xiv Për sa i përket burimit të tretë të shërbyer për ndërtimin e objektit, të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes, janë analizuar dhe pasqyruar në analizën financiare, në tabelën më poshtë.

1.14.xv Për arsye se subjekti ka deklaruar se investimi i ndërtimit të kësaj pasurie ka kushtuar 1.800.000 lekë dhe se për të provuar këtë deklaramin subjekti nuk depozitoi dokumentacion, Komisioni, për të nxjerrë koston reale të investimit është bazuar në çmimet e Entit Kombëtar të Banesave mbi kostot e ndërtimit.

1.14.xvi Në të tilla kushte, referuar udhëzimit nr.1, datë 8.5.2003, të Entit Kombëtar të Banesave, rezulton se kostoja për sip. ndërtimi lekë/m² për vitin 2003, në Sarandë është 23.131 lekë.

1.14.xvii Nga përllogaritjet e kryera, vlera e investimit me kostot e Entit Kombëtar të Banesave, së bashku edhe me blerjen e truallit shtetëror ka rezultuar, si më poshtë:

Tabela nr. 6

Kostoja për sip. ndërtimi lekë/m ² sipas EKB-së për vitin 2003 (1)	Sipërfaqe e ndërtuar 1+1 kate (2)	Vlera e investimit (3)=(1)x(2)	Trualli (4)	Total (3)+(4)
23,131	120 +120	5,551,440	145,920	5,697,360

1.14.xviii Gjithashtu, pasuria apartament (e trajtuar më poshtë në pikën 4) dhe pasuria truall (e trajtuar në deklaramin e bashkëshortes së subjektit), janë përfshirë në tabelën më poshtë për shkak se janë krijuar të dyja në vitin 2003, vit në të cilin është investuar për ndërtimin e objektit 1+1.

Tabela nr. 7

	1997 – 2003
1. Të ardhura	4,308,873
Të ardhura nga subjekti 1997 – 2003	3,352,970
Të ardhura nga bashkëshortja 1997 – 2003	955,903
Të ardhura nga kurset e bashkëshortes	
Hua Gj. D.	
Hua A. M.	
Hua/dhurim ⁴³ I. M.	300,000

⁴³Komisioni hetoi lidhur me këtë dhurim dhe nga verifikimi i dokumentacionit të punësimit të prindërve të subjektit (depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 18.12.2019) dhe nuk i rezultuan problematika.

Dhurime nga familjarët e bashkëshortes	
2. Shpenzime	1,085,456
Shpenzime jetese	975,456
Shpenzime arredimi ap. Sarandë	110,000
3. Pasuri	10,348,191
Ndërtimi i objektit 1+1 kate	5,697,360
Ap. 54 m ² në Sarandë ⁴⁴	2,871,220
Truall 1.000 m ² në F.	320,000
Likuiditete	1,459,611
Balanca (1-2-3)	- 6,824,774⁴⁵

1.14.xix Nga analiza financiare, duke mos përfshirë të ardhurat nga kurset e mësimdhënies të bashkëshortes së subjektit, dhurimet e familjarëve të saj, si dhe huat e marra gjatë viteve 2002 – 2004, Komisionit i rezultoi: se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 6.824.774 lekë për të kryer të gjitha investimet gjatë vitit 2003, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; se dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i dy huadhënësve, përkatësisht shtetasve Gj. D. për shumën 1.700.000 lekë dhe A. M. për shumën 1.000.000 lekë, si dhe dukej i dyshimtë çmimi i shitjes së kësaj pasurie në vlerën 1.800.000 lekë (trajtuar në pasurinë e parë), ndërkohë që investimi sipas kostove të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave rezulton në shumën 5.551.440 lekë dhe për pasojë i kaloi subjektit barrën e provës⁴⁶.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.14.xx Subjekti në parashtrime ka qartësuar se ka qenë konsekuent që në deklarin e pasurisë së vitit 2003 dhe në vijim deri në përgjigjet e pyetësorëve se objekti 1+1 ka qenë i papërfunduar, ka qenë karabina dhe i tillë është shitur në vitin 2004. Në përgjigjen e pyetësorit nr. 3, datë 17.1.2020, subjekti është shprehur se ka sqaruar edhe lapsusin në aktin e kolaudimit. Ometimi për të specifikuar shprehimisht në regjistrimin në ZVRPP-së dhe në kontratën e shitjes (të nënshkruar jo nga subjekti personalisht, por nga përfaqësuesi me prokurë) faktin se objekti ishte në gjendjen e mësipërme, nuk duhet të shërbejë për t'i ngarkuar në vitin 2003 një shpenzim imagjinar prej 5.697.360 lekësh. Gjithashtu, subjekti shprehet se edhe nga ana ekonomike nuk do të kishte asnjë logjikë që të shiste tri herë më lirë një pronë për të cilën kishte shpenzuar shumën e vendosur nga Komisioni.

1.14.xxi Subjekti ka cituar në mënyrë kronologjike duke i cituar me zëra financiarë të ardhurat, të cilat nuk janë konsideruar si huat e marra, paga për vitin 1996 prej kohës së nisjes së detyrës, shpenzimet e tepërta krahasimisht me numrin e anëtarëve të familjes, por edhe ka kundërshtuar

⁴⁴Subjekti deklaron se huan e ka marrë në fund të vitit 2002, kohë në të cilën kursi mesatar i muajit dhjetor 2002, sipas Bankës së Shqipërisë ka qenë 1 USD = 134,966 lekë, ndërsa kursi mesatar i muajit janar 2003, po sipas Bankës së Shqipërisë, ka qenë 1 USD = 131,66 lekë. Meqenëse është e pamundur të përcaktohet koha kur mund të jetë kryer konvertimi, Komisioni ka vlerësuar që për analizën e kësaj pasurie, të marrë në konsideratë kursin e datës së kontratës së shitjes (31.1.2003), sipas Bankës së Shqipërisë (1 USD = 130,51 lekë).

⁴⁵Ky rezultat ishte në analizën financiare në fazën e hetimit administrativ dhe në dërgimin e rezultateve të hetimit.

⁴⁶Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

vlerën e lartë të përfshirë sipas çmimeve të Entit Kombëtar të Banesave në analizën financiare. Në tërësi, subjekti kundërshton analizën financiare e cila ka rezultuar në balancë negative, duke pretenduar rillogaritje në zërat specifike financiarë, të cilët do të ndryshonin balancën negative.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.14.xxii Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit për të mos ripërsëritur konstatimet e ligjshmërisë së huadhënieve në tërësi, në arsyetim është fokusuar në rillogaritjet e bëra në analizën financiare duke konsideruar disa pretendime të subjektit të rivlerësimit. Në këtë kontekst, trupi gjykues përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor, sikurse ka kërkuar subjekti, ka vlerësuar të përfshijë në analizën financiare të të ardhurat, pagat e vitit 1996, si dhe të ardhurat nga interesat bankare.

1.14.xxiii Për sa i përket interesave bankare, në analizë të dokumentacionit të depozituar nga bankat dhe subjekti u përfshinë interesat e përfituara në vitet 2001– 2003 për depozitat në monedhat lekë, USD dhe euro, si për subjektin ashtu edhe për bashkëshorten. Totali i përfituar nga interesat bankare duke i shumëzuar me kursin mesatar (sipas Bankës së Shqipërisë) për secilin vit, rezultoi në shumën 71.939 lekë.

1.14.xxiv Në lidhje me pagën e vitit 1996, e rezultuar në vlerën 222.536 lekë, pas përfshirjes së saj si e ardhur, normalisht u përlllogaritën edhe shpenzimet e jetesës për atë vit (70 % e të ardhurave), të cilat rezultuan në shumën 155.775 lekë.

1.14.xxv Si rezultat i përfshirjes së shumave (interesat e viteve 2001 – 2003, pagat e vitit 1996 dhe shpenzimet e jetesës për vitin 1996), analiza financiare e kryer për vitet 1997 – 2003, konkludoi nga balancë negative në shumën 6.824.774 lekë, pas rillogaritjes për vitet 1996 – 2003, në balancë negative në shumën 6.686.074 lekë.

1.14.xxvi Për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues investimin/shumën e shpenzuar për ndërtimin e objektit edhe pas prapësimeve, trupi gjykues nuk vlerëson të ndryshojë qëndrim në rillogaritjen e këtij zëri financiar, i cili i referohet përlllogaritjeve sipas kriterëve ligjore të Entit Kombëtar të Banesave. Nga ana tjetër, trupi gjykues i ka qëndruar regjistrimit hipotekor, kontratës së shitjes (trajtuar gjerësisht në pikën 1.7), ku në secilën prej tyre pasqyrohet ndërtimi 1+1 dhe jo një regjistrim karabina. Në të tilla rrethana, dy kanë qenë arsytet e diktuarat për të analizuar dhe përlllogaritur shpenzimin e kryer në këtë objekt. Subjekti ose duhet të provonte me dokumentacion justifikues shpenzimin e kryer dhe jo sikurse ai ka paraqitur deklaratë noteriale nga shtetasi D. B. si ndërtues i objektit, ose në këtë pamundësi, si referenca mbizotërojnë llogaritjet sipas kostove të EKB-së.

Tabela nr. 8

	1996 – 2003
1. Të ardhura	4,903,348
Të ardhura nga subjekti 1996 – 2003	3,575,506
Të ardhura nga bashkëshortja 1997 – 2003	955,903
Hua/dhurim I. M.	300,000
Interesa bankare	71,939

2. Shpenzime	1,241,231
Shpenzime jetese	1,131,231
Shpenzime arredimi ap. Sarandë	110,000
3. Pasuri	10,348,191
Ndërtimi i objektit 1+1 kate	5,697,360
Ap. 54 m ² në Sarandë	2,871,220
Truall 1.000 m ² në F.	320,000
Likuiditete	1,459,611
Balanca (1-2-3)	- 6,686,074

Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave në tërësi, trupi gjykues çmon se nuk janë bindëse, pasi në asnjë rast subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, pasi:

- ✓ Bazuar në rillogaritjet e bëra në analizën financiare rezulton se ka mungesë të të ardhurave në shumën **6,686,074** lekë, për të kryer të gjitha investimet gjatë vitit 1996 deri në vitin 2003, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.
- ✓ Subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë me dokumentacion justifikues vlerën e shpenzuar për ndërtimin e objektit dhe për pasojë ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e kësaj pasurie, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

1.14.xxvii Gjithashtu, po për këtë objekt, nga analiza e dokumentacionit të administruar, rezultuan paqartësi në lidhje me ndërtimin e të gjithë godinës, për të cilën u krijua dyshimi i arsyeshëm se objekti ka qenë tërësisht i ndërtuar në vitin 2003, për shkak se:

- i. Referuar aktit të kolaudimit, pasuria cilësohet e përfunduar me përshkrimin (3) kate plus një kat nëntokë me sipërfaqet dhe funksionet përkatëse.
- ii. Subjekti deklaroi gjatë hetimit se emërtimet e funksioneve të kateve në aktin e kolaudimit janë bërë thjesht sipas emërtimeve të tyre në projekt, pasi as nuk kanë qenë të banueshme dhe as nuk janë vënë në funksion ndonjëherë, duke lënë të nënkuptohet se objekti ka qenë i ndërtuar, pavarësisht se ka qenë i pabanueshëm dhe në këto kushte iu kërkua të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.14.xxviii Subjekti ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit dhe ka depozituar disa pamje satelitore prej vitit 2003, kohë në të cilën ka nisur dhe përfunduar ndërtimi i objektit 1+1 e deri në vitin 2016, për të provuar se ky ndërtim nga subjekti ka mbetur vetëm në këtë numër katesh.

Pamja satelitore pasardhëse që gjendet në *Google Earth* është e datës 14.4.2006 (dy vjet pas shitjes nga subjekti) dhe më pas vjen pamja e datës 21.8.2007 (mbi tre vjet pas shitjes nga subjekti). Po në vitin 2007 janë bërë foto ajrore shumë të qarta nga ASIG. Nga këto foto kuptohet mjaft qartë se objekti ka qenë një ndërtim i papërfunduar karabina dhe jo më i lartë se 1+1 kate.

Subjekti ka sqaruar se ngritja e kateve të tjera konstatohet vetëm në vitin 2010 nga imazhi satelitor i *Google Earth*, datë 10.5.2010, e në vijim. Vlerësimi profesional i fakteve urbanistike dhe inxhinierike që rezultojnë nga imazhet satelitore të *Google Earth* dhe pamjet ajrore të ASIG, të lidhura edhe me pamjet e rrugës të marra nga *Google Maps*, janë bërë nga ekspertët e fushës në aktin e ekspertimit të datës 22.2.2020, të cilin e ka paraqitur si provë.

Subjekti ka depozituar aktekspertimin “mbi vlerësimin e përgjithshëm urbanistik dhe inxhinierik në bazë të fakteve hartografike të marra nga pamje satelitore dhe ajrore në vite”, datë 22.2.2020, nga urbanistët A. K. dhe J. Xh., si dhe deklaratat noteriale të shtetasve D. B. (ndërtuesi), Dh. L. (kolaudatori) dhe P. G. (blerësi), të cilët deklarojnë pikërisht faktin e deklaruar nga subjekti që në vitin 2003 e në vijim, se objekti ishte i papërfunduar, konstruksion betonarme e me tulla të lehtësuara dhe më konkretisht:

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.2.2020, e shtetasit D. B.;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.2.2020, e shtetasit Dh. L.;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.2.3020, e shtetasit P. G. .

Arsyetimi dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.14.xxix Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti, edhe pse nuk gjen me vend deklarin e kolaudatorit, z. Dh. L., për shkak të pozicionit dhe përgjegjësisë që mban lidhur me aktet që përgatit, ku megjithëse në vitin 2003, kohë në të cilën është ndërtuar dhe deklaruar nga subjekti ky objekt, ka nënshkruar e vulosur një akt kolaudimi tejet të detajuar me numër katesh të godinës dhe me funksionin e secilit kat dhe nga ana tjetër deklaroi se formularët e kolaudimit ishin standard, gjë që nuk mund të ndodhë për shkak se objekti nga objekti ndryshon, se kishte plotësuar gabimisht numrin e kateve (3) të objektit, ndërsa në fakt ishte një kat garazh dhe një kat banesë dhe se për këtë konstatim ishte drejtuar në zyrën e hipotekës, ku dhe kishte bërë shënimin përkatës në aktin e kolaudimit.

1.14.xxx Trupi gjykues, nga verifikimi i aktit të kolaudimit, ka konstatuar shënimin e bërë, konkretisht: *përfunduar vetëm kati përdhe dhe kati i parë*, si dhe duke cituar bri pasqyrimin: *kati i dytë dhe i tretë janë në vazhdim*, por nuk ka konstatuar që shënimi të jetë nënshkruar dhe vulosur nga kolaudatori ashtu sikurse ka vepruar me përmbajtjen e aktit në tërësi. Në deklarin e kolaudatorit vihet re fakti se ndërsa deklaroi në deklaratën noteriale të datës 15.2.2020 se objekti ishte i ndërtuar garazh dhe 1 kat banesë, nuk reflektohet te dy deklaruësit e tjerë, përkatësisht te ndërtuesi i objektit dhe blerësi, të cilët deklarojnë se objekti ka qenë i papërfunduar.

1.14.xxxi Edhe nëse i referohemi pamjeve satelitore nga *Google Earth* të depozituara nga subjekti në prapësime, por edhe aktit të vlerësimit të përgatitur nga urbanistë të licensuar të fushës, vërejmë se në akt kanë konkluduar se në pamjen satelitore të datës 5.7.2003 në zonë nuk evidentohen ndërtime, pra, janë shprehur në një linjë me deklarin e subjektit se ndërtimi kishte nisur në korrik të vitit 2003 dhe se kishte përfunduar në tetor të po këtij viti. Gjithashtu, vlerësuesit kanë qartësuar më tej lidhur me pamjen satelitore të datës 14.4.2006, se në zonë ka filluar ndërtimi, pra, sheshi nuk është më zonë natyrore. Edhe ky konkluzion tregon tashmë faktin se ishin kryer ndërtime, madje në nivel zone. Konstatohet se ekspertët nuk kanë konkluduar lidhur me faktin nëse ndërtimi ka qenë apo jo i përfunduar.

- ✓ Trupi gjykues, i ndodhur në këto rrethana konstatuese, në raport me deklarin e subjektit ndër vite, apo palëve (kolaudatorit, ndërtuesit, blerësit, deklarime të kryera gjatë procesit të rivlerësimit), në referencë edhe të aktit vlerësues, çmon se konkurrojnë provat, siç është

kontrata e shitjes së pasurisë, si dhe regjistrimi përkatës të cilët pasqyrojnë përfitimin e pasurisë dhe regjistrimin e objektit 1+1 të përfunduar.

- **Në lidhje me ekzistencën e konfliktit të interesit për shkak të ushtrimit të detyrës, me inxhinierin kolaudues, me blerësin e pasurisë, me kompaninë ndërtuese të pasurisë “****” sh.p.k., si dhe me përfaqësuesit e saj.**

1.15 Komisioni ka hetuar në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi (shqyrtimin e ndonjë çështjeje gjyqësore) midis subjektit të rivlerësimit dhe kompanisë ndërtuese apo edhe personave që përfaqësojnë pozicionet e cilësuar më sipër, konkretisht, shtetasit P. G., Dh. L., V. P., D. B., L. M., H. M., nga ku rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë⁴⁷ nuk ka konfirmuar shqyrtim të çështjeve civile apo penale me këto palë, në këtë gjykatë, në kohën (1998 – 2004) që subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën.

- ✓ Në kushte të tilla, trupi gjykues nuk konstatoi veprime që bien ndesh me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, sa i përket qenies në konflikt interesi në veprimet e ndërmarra për krijimin dhe më tej edhe për shitjen e kësaj pasurie.

2. Në lidhje me garazhin për automjet me sip. 25.3 m², me adresë: Blv “**”, p. ***, Tiranë, përfituar me kontratë shitjeje noteriale nr. ***, datë 10.12.2007, në vlerën 1.500.000 lekë.**

Burimi i deklaruar i pasurisë:

- a. të ardhura familjare nga puna;
- b. hua (e kthyer plotësisht).

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁸.

2.1 ILDKPKI-ja është shprehur në raport: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë.

Faktet e konstatuara nga hetimi administrativ i Komisionit

2.2 Subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2007 me përshkrimin “kontratë shitjeje nr. ***, datë 10.12.2007 me shoqërinë “****” sh.p.k., për blerje garazhi me sip. 25.3 m² në të njëjtën godinë me apartamentin.”

2.3 Kjo pasuri konfirmohet me kontratë⁴⁹ shitjeje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 10.12.2007, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k., dhe palë blerëse shtetasin Ardit Mustafaj me çmimin 1.500.000 lekë, shumë e cila sipas parashikimit kontraktor është likuiduar tërësisht nga blerësi në favor të palës shitëse jashtë zyrës noteriale.

2.4 Nga korrespondenca e mbajtur me institucionet publike ka rezultuar se:

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2019 ka informuar se nga verifikimi rezulton se z. Ardit I. Mustafaj ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë me të dhënat, si më poshtë:

- pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, lloji i pasurisë garazh me sip. 25.3 m².

⁴⁷Korrespondenca e Komisionit nr. *** prot., datë 23.1.2020, me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, nr. *** prot., datë 29.1.2020 dhe nr. *** prot., datë 29.1.2020, në dosjen e Komisionit.

⁴⁸Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 10.12.2007; vërtetim hipotekor nr. *** , datë 15.12.2007, për garazh me sip. 5.36 m², Rr. “****”, Tiranë (aneksi nr. 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴⁹Aneks 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së.

2.5 Komisioni hetoi në lidhje me secilin nga burimet e krijimit të kësaj pasurie sipas deklaramit të subjektit.

a. Në lidhje me të ardhurat familjare nga puna

2.6 Komisioni ashtu siç është shprehur edhe në pasurinë nr.1, gjatë hetimit i ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore, ku nga korrespondencat institucionale (nga punëdhënësit përkatës) janë pasqyruar dhe konfirmuar të ardhurat e tyre. Në të tilla kushte, Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e përdorura për investimin e kryer.

✓ Në analizë të dokumentacionit provues, trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika lidhur me të ardhurat e konfirmuara zyrtarisht nga institucionet punëdhënëse.

b. Hua në shumën 1.000.000 lekë, marrë nga shtetasi A. M. e kthyer plotësisht)

2.7 Subjekti e deklaroi këtë hua në deklaratën periodike të vitit 2007 me përshkrimin “hua me qëllim blerje garazhi, sipas kontratës noteriale nr. ***, datë 10.12.2007 dhe është me afat kthimi 2 (dy) vjet nga data e lidhjes së saj, pa interes”.

2.8 Në lidhje me huadhënësin, z. A. M., Komisioni është shprehur (në pasurinë nr. 1) për hetimin e kryer dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti lidhur me punësimin e këtij shtetasi.

2.9 Të ardhurat e përfituara nga punësimi për llogari të huadhënësit rezultojnë, si më poshtë:

Tabela nr. 9

Viti	Paga vjetore	Institucioni punëdhënës
Prill 2004	321,440	Ujësjetllës Kanalizime, Sarandë
2005	404,000	
2006	434,660	
2007	437,136	
	1,597,236	

Viti	Paga	Institucioni punëdhënës ⁵⁰
Mars 2005	375,000	*** Durrës Albania
2006	468,751	
2007	900,000	
	1,743,751	

2.10 Nga përlllogaritjet në tabelë, në total, të ardhurat rezultojnë në shumën 3.340.987 lekë, ligjshmëria e të cilave provohet për shumën 1.597.236 lekë, shumë e cila mbulon vlerën prej 1.000.000 lekësh të dhënë hua edhe nëse i zbrësim shpenzimet e jetesës.

⁵⁰Mungon dokumentacioni për provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si të përfituara nga “***” Durrës, Albania.

2.11 Komisioni, bazuar në dokumentacionin provues ligjor, kreu analizën financiare për vitin 2007, periudhë kur është blerë kjo pasuri nga ku ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në këtë pasuri, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

- ✓ Në të tilla kushte, trupi gjykues çmon se në përmbushje të parashikimit ligjor të bërë në pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, provohet burimi i ligjshëm i shumës 1.000.000 lekë, dhënë hua nga shtetasi A. M. .

3. Në lidhje me garazhin për automjet me sip. 18.31 m², me adresë: Blv “****”, p. ***, Tiranë, përfituar me kontratë shitjeje noteriale nr. ***, datë 30.6.2014, në vlerën 1.283.800 lekë. Burimi i deklaruar i krijimit: të ardhura familjare nga puna .

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁵¹.

3.1 ILDKPKI-ja është shprehur në raport: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë.

Faktet e konstatuara nga hetimi administrativ i Komisionit

3.2 Nga hetimi ka rezultuar se subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 me përshkrimin “blerje garazhi automjeti, me sip. 18.31 m², me vendndodhje në Tiranë, burimi me kursimet familjare në vite nga të ardhurat nga puna dhe në të njëjtën vlerë janë pakësuar edhe kursimet e depozituara në bankë”. Vlera: 1.283.800 lekë.

3.3 Kjo pasuri konfirmohet me kontratën⁵² shitje pasurie të paluajtshme (garazh) nr. ***, datë 30.6.2014, me palë shitëse D. dhe S. D. dhe palë blerëse z. Ardit Mustafaj. Çmimi prej 1.283.800 lekësh është likuiduar tërësisht nga blerësi në favor të palës shitëse nëpërmjet bankës. Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2019, ka informuar se nga verifikimi rezulton se z. Ardit I. Mustafaj ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë me të dhënat, si më poshtë:

- pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, lloji i pasurisë garazh me sip. 18.31 m².

3.4 Nga analiza e kryer nga Komisioni për kursimet ndër vite të subjektit (*cash* dhe në bankë), vihet re se viti 2013 mbyllet me depozitë në vlerën 1.946.352 lekë.

Tabela nr.10

Viti	2009	2010	2011	2012	2013
Depozita në BKT					1,946,352
<i>Cash</i>	210,000	530,000	1,010,000	1,520,000	150,000

3.5 Në datën 30.6.2014 maturohet njëra prej depozitave në shumën 1.553.263,33 lekë dhe po në këtë datë është kryer pagesa për blerjen e garazhit me transaksion bankar drej shitësit, shtetasit D. H. D. me përshkrimin “kalim shume për blerje garazhi”.

⁵¹Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 30.6.2014, + praktika e kontratës; certifikatë pronësie nr. ***, datë 4.7.2014, për garazh me sip. 18.31 m², Rr. “****”, Tiranë (Aneksi nr. 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵²Aneks 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së.

3.6 Subjekti, për shkak të kursimeve, ka pasur mundësi financiare në datën 30.6.2014 të blejë garazhin në shumën 1.283.800 lekë.

3.7 Komisioni kreu analizën financiare edhe për gjithë vitin 2014 mbi mundësitë financiare të subjektit, nga ku rezultoi se ka pasur mundësi financiare për të investuar në blerjen e pasurisë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare përgjatë vitit 2014.

✓ Në kushte të tilla, trupi gjykues nuk konstaton problematika në lidhje me ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie.

4. Në lidhje me apartamentin me sip. 54 m², me adresë: Rr. “**”, lagjja nr. ***, Sarandë, përfituar me kontratë shitjeje noteriale nr. ***, datë 31.1.2003, në vlerën 22.000 USD.**

Burimi i deklaruar i krijimit:

- a. hua (e kthyer plotësisht);
- b. të ardhura nga puna e subjektit dhe e bashkëshortes;
- c. të ardhura të bashkëshortes para martesë.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁵³.

4.1 ILDKPKI-ja është shprehur në raport: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e ZQRPP-së.

Faktet e konstatuara nga hetimi administrativ i Komisionit

4.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2003 me përshkrimin “apartament banimi me sip. 54 m² + truall 12 m². Adresa: lagjja nr. ***, Sarandë. Pjesa takuese: 50%. Vlera: 2.250.000 lekë”. Burimi i krijimit:

- a) hua nga z. Gj. D. në shumën 1.700.000 lekë;
- b) të ardhura nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes;
- c) të ardhura të bashkëshortes të krijuara para martesë.

4.3 Kjo pasuri konfirmohet me kontratë shitjeje (pasurie të paluajtshme) nr. ***, datë 31.1.2003, me palë shitëse S. dhe R. H. dhe palë blerëse Ardit Mustafaj, me çmim shitjeje 22.000 USD, shumë të cilën sipas parashikimit kontraktor subjekti ua ka paguar shitësve para lidhjes së kontratës, jashtë zyrës noteriale.

4.4 Subjekti është pyetur⁵⁴ për mënyrën e likuidimit të kësaj pasurie dhe ka deklaruar:

- 5.000 USD janë paguar në kohën kur është lidhur kontrata e shitjes;
- 17.000 USD janë paguar në fund të dhjetorit të vitit 2003.

Komisioni hetoi për secilin nga burimet e përdorura për këtë pasuri.

- a. Në lidhje me huan në shumën 1.700.000 lekë nga shtetasi Gj. D.

4.5 Subjekti e ka deklaruar huan në deklaratën periodike të vitit 2003 me përshkrimin “hua nga Gj. D., në vlerën 1.700.000 lekë për blerje-ndërtim banese”.

⁵³Kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme me nr. ***, datë 31.1.2003, për ap. me sip. 54 m², në vlerën 22.000 USD, Sarandë, blerës z. Ardit Mustafaj; vërtetim hipotekor datë 24.2.2003, për ap. me sip. 54 m², Sarandë (aneksi nr. 4/5, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵⁴Pyetësori nr. 2, datë 18.12.2019.

Data e dhënies së huas	Shuma e marrë	Shuma e shlyer	Dokumentacioni justifikues
2002 – 2003	1,700,000	1,360,000	Deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.2.2007
28.12.2006		340,000	Deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.2.2007

4.6 Subjekti është pyetur⁵⁵ në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit, nga ku ka deklaruar: “...kujtoj se në fund të vitit 2002 është marrë hua shuma 1.300.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 400.000 lekësh është marrë rreth muajit korrik të vitit 2003”.

4.7 Subjekti ka sqaruar se shtetasi Gj. D. ka pasur dhe ka aktivitet privat në fushën e prodhimit të brumit dhe pastiçerisë, konkretisht, në dy shoqëri: “****” sh.p.k., me NIPT *** dhe Gj. D. person fizik me nr. NIPT ***.

4.8 Subjekti, gjithashtu, është pyetur⁵⁶ për fitimin e realizuar nga aktiviteti privat i shtetasit Gj. D. . Në përgjigje, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2019, nga drejtoria rajonale tatimore Sarandë, ku konfirmohet fitimi i realizuar për shoqërinë “****” sh.p.k., në vitet 1994 – 1995. Më tej, kjo drejtori ka konfirmuar se për shoqërinë “****” sh.p.k. nuk zotëron për vitet e tjera pasqyra financiare, ndërsa për biznesin “Gj. D.” informon se nuk ka të dhëna për këtë periudhë.

4.9 Informacioni dhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti mbi të ardhurat e përfituara nga aktiviteti privat për këtë shtetas, duket se nuk është i mjaftueshëm për të provuar shumën e dhënë hua dhe për të konfirmuar burimin e ligjshëm të saj.

4.10 Nga hetimi ka rezultuar se shtetasi Gj. D. në kohën (2002 – 2003) e dhënies së huas ka marrë disa kredi.

4.10.i Më konkretisht, nga korrespondenca e mbajtur nga Komisioni me institucionet financiare, Fondi Besa me shkresën nr. *** prot., datë 2.5.2019 informon mbi kreditë e marra nga shtetasi Gj. D., siç pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Tabela nr.11

Data	Shuma e kredisë	Shuma e paguar (principal+interes)	Data e mbylljes
22.10.2001	300,000	310,000	Janar 2002
19.3.2002	1,400,000	1,742,986.45	1.1.2004
20.1.2004	1,400,000	1,822,469	19.4.2006

4.10.ii Nga të dhënat e pasqyruara, duket se huadhënësi ka qenë në vështirësi financiare, pasi brenda tri (3) viteve ka marrë tri kredi në total në shumën 3.100.000 lekë.

4.11 Komisioni ka mbajtur korrespondencë edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila në përgjigje ka dhënë informacion për Gj. D. P.F. me nr. NIPT *** nga viti 2009 e në vazhdim, periudhë kjo që nuk korrespondon me kohën kur është dhënë huaja. Ndërsa, për shoqërinë “****” sh.p.k. me nr. NIPT ***, DPT-ja informon se subjekti është regjistruar në datën 1.7.1996 dhe në sistemin c@ts nuk ka informacion. Mbi këto konstatime, Komisionit i

⁵⁵Pyetësori nr. 2, datë 18.12.2019.

⁵⁶Referoju pyetësorit nr. 3, datë 17.1.2020.

rezultoi se dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i shumës 1.700.000 lekë, të dhënë hua në vitet 2002 – 2003, nga shtetasi Gj. D., se mungonte dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua, bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe për pasojë i kaloi subjektit barrën e provës⁵⁷.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

4.12 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se biznesi “Gj. D.” si tatimpagues “***” sh.p.k. dhe person fizik Gj. D. kanë qenë të regjistruar sipas përgjigjeve të dhëna nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, nga Bashkia Sarandë (drejtoria e taksave dhe tarifave vendore) dhe nga dega e sigurimeve shoqërore Sarandë. Subjekti ka cituar edhe përgjigjet e shkresave dhe njëkohësisht ka shpjeguar se nga përgjigjet e dhëna konfirmohen pagesa të detyrimeve tatimore.

4.12.i Po ashtu, subjekti, ka sqaruar se sipas përgjigjeve institucionale është konfirmuar fitimi i realizuar për shoqërinë “***” sh.p.k. për vitet 1994 –1995, sipas bilanceve të këtyre dy viteve dhe se Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë ka konfirmuar se për këtë shoqëri nuk zotëron pasqyra financiare për vitet e tjera, ndërsa për biznesin “Gj. D.” informon se nuk ka të dhëna për këtë periudhë.

4.12.ii Subjekti pretendon se ka kërkuar me këmbëngulje duke depozituar disa herë kërkesa lidhur me konfirmimin e të ardhurave nga biznesi “Gj. D.”, por institucionet shtetërore kanë konfirmuar ushtrimin e aktivitetit privat nga Gj. D. edhe si Person juridik edhe si Person fizik, por nuk kanë mundur të dhëna lidhur me të ardhurat e siguruara prej z. Gj. D. .

4.12.iii Së fundmi, shtetasi Gj. D. ka kërkuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, që të konfirmojë nëse gjendet fizikisht dokumentacioni tatimor për periudhën 1999 – 2003, lidhur me aktivitetin privat të ushtruar prej tij, për të cilin, ndër të tjera, me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2020, drejtoria ka konfirmuar: *“...për sa i përket dokumenteve të tjera justifikuese, për të cilat z.Gj. D. është regjistruar në librat e protokollit pranë DRT-së Sarandë, nuk mundëm të gjejmë dokumente justifikuese, pasi nga transferimi i ambienteve të DRT-së Sarandë nga viti 1993 deri në vitin 2007, ku DRT-ja Sarandë ka ndryshuar disa herë vendndodhje, ndoshta këto dokumente justifikuese mundet të jenë dëmtuar gjatë transferimit të dosjeve të arshivës.”*

4.12.iv Subjekti ka kërkuar që në referencë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pikat 2 e 5, të nenit 32, të merren parasysh të ardhurat e marra hua nga shtetasi Gj. D. .

4.12.v Subjekti ka referuar legjislacionin mbi procedurat tatimore, atë të ushtrimit të biznesit të vogël, etj., si dhe ka analizuar dhe bërë disa përllogaritje mbi të cilat pretendon se huadhënësi ka pasur mundësi në dhënien e shumës 1.700.000 lekë subjektit, dhe se marrjen e kredive sipas parimeve të ekonomisë së tregut e qartëson se nuk tregon vështirësinë financiare përgjatë gjithë periudhës, por në periudha të ndryshme bizneset mund të kenë nevoja për mjete qarkulluese (likuiditete).

4.12.vi Subjekti ka qartësuar gjithashtu, se marrja e kredive është pasuar me kthimin e tyre në kohë, madje edhe më parë, çka tregon se huadhënësi ka pasur të ardhura të mjaftueshme dhe të qëndrueshme nga aktiviteti privat. Subjekti pretendon se në këto rrethana, ndodhet në kushtet

⁵⁷Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafët 3 dhe 5 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

e pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

4.12.vii Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton se përgjigjet e institucioneve kanë konfirmuar regjistrimin e shtetasit Gj. D. me aktivitet privat, por nuk kanë rrëzuar konfirmimin e bërë më herët me shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2019 (të DRT-së Sarandë), ku konfirmohet vetëm fitimi i realizuar për shoqërinë “***” sh.p.k., në vitet 1994 – 1995, ndërsa për më tej kjo drejtori ka konfirmuar se për këtë shoqëri nuk disponon për vitet e tjera pasqyra financiare dhe se për biznesin “Gj. D.” nuk ka të dhëna. Po ashtu, trupi gjykues konstaton se institucioni i DPT-së ka informuar Komisionin që në rezultatet e hetimit duke dhënë informacion për Gj. D. P.F. me nr. NIPT ***, për aktivitet nga viti 2009 e në vazhdim, periudhë kjo që nuk shërben as si provë indirekte, pasi huaja daton që në vitin 2002 apo edhe në vijim, në vitin 2003.

4.12.viii Trupi gjykues nga dokumentacioni i administruar për vlerësimin e të ardhurave nga shtetasi Gj. D. dhe bashkëshortja, nga aktiviteti privat si person fizik, në raport me pretendimin e subjektit për pagat e përfituara, çmon se në analizë të dokumentacionit të depozituar, nuk mund t’i marrë në konsideratë, pasi Instituti i Sigurimeve Shoqërore Dega e Sigurimeve Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 28.1.2020, ka konfirmuar se subjekti “Gj. D.” P.F. ka dorëzuar listpagesa për periudhën tetor 2008 – dhjetor 2011, periudhë kjo që nuk i përket kohës së huadhënies. Po ashtu, konstatohet se edhe pagesat e sigurimeve shoqërore nuk janë në vazhdimësi, por me periudha kohore të shkëputura⁵⁸, e specifikisht referohet se shtetasi Gj. D. P.F. ka paguar sigurime shoqërore në periudhat kohore 1.12.1992 – 30.9.1993, 1.7.1998 – 30.6.1999 dhe 1.1.2001 – 30.6.2001. Gjithashtu, trupi gjykues nuk i gjen bindëse shpjegimet e subjektit mbi këtë pretendim, pasi çmon se aktiviteti me statusin Person Fizik, nuk merr paga realisht çdo muaj, por vetëm paguan detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për efekt pensioni, “zë” i cili faktikisht është vetëm shpenzim në bilancin e një aktiviteti Person Fizik.

Trupi gjykues, në vlerësim të dokumentacionit të administruar për të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë “***” sh.p.k., ka konstatuar se referuar kartelave të tatimit mbi të ardhurat për shoqërinë “***” sh.p.k., me administrator z. Gj. D., me nr. NIPTI ***, jepen të dhëna për përcaktimin e detyrimit mbi të ardhurat dhe pagesat dhe gjithashtu, deri në vitin 1998 konfirmohen pagesat e tatimit, por, ndërkohë konstatohet se çelja e vitit 2002 është bërë me minus. Po ashtu, në analizë të të dhënave të marra nga ISSH-ja Dega e Sigurimeve Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 28.1.2020, informohet se shoqëria “***” sh.p.k. ka depozituar listpagesa për periudhën mars 1995 dhe për periudhën maj – dhjetor 1995, periudhë kjo që nuk mund të sigurojë të ardhura të mjaftueshme edhe sikur Komisioni të përlllogarisë pagën maksimale, sipas legjislacioni të kohës.

4.12.ix Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk provoi se ishte në pamundësi objektive për të zotëruar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e huadhënies, që ka shërbyer si burim krijimi i pasurisë për shkak se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit për të provuar ligjshmërinë e huas së marrë në shumën 1.700.000 lekë nga shtetasi Gj. D. kanë mbetur në nivel deklarativ dhe jo të provuar, sipas kërkesave të pikës 3, të nenit D, të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr.84/2016.

⁵⁸Referoju shkresës nr. *** prot., datë 29.1.2020.

4.12.x Në vijim, trupi gjykues, në lidhje me dy burimet e tjera të krijimit të kësaj pasurie, përkatësisht: (b) të ardhura nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes dhe (c) të ardhura të bashkëshortes të krijuara para martesë, nuk mund të përsëritet në arsyetim pasi është shprehur më lart për to, si dhe i ka pasqyruar në analizën financiare të kryer për vitin 2003.

4.12.xi Meqenëse në vitin 2003 subjekti ka kryer investime në disa pasuri të paluajtshme: (i) ka ndërtuar objektin 1+1 kate në Sarandë (trajtuar më sipër); (ii) bashkëshortja ka blerë truallin me sip. 1000 m² në F. (deklarim i pasurisë së bashkëshortes në vijim); si dhe (iii) ka blerë këtë pasuri, Komisioni kreu analizën financiare të vitit 2003, kur janë kryer këto investime duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe bashkëshortes për vitet 1996 – 2003 (referuar tabelës nr. 8 më sipër). Në përfundim për këtë pasuri trupi gjykues konstaton se:

✓ Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues burimin e ligjshëm të shumës 1.700.000 lekë, marrë hua nga shtetasi Gj. D., sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

✓ Bazuar në rillogaritjet e bëra në analizën financiare për vitin 2003, rezultoi se ka mungesë të të ardhurave në shumën 6,686,074 lekë, për të justifikuar pagesën e shumës 22.000 USD për këtë pasuri në vitin 2003, deklaruar në deklaratën “Vetting”, si dhe për të përbaluar shpenzimet e tjera familjare.

5. Në lidhje me automjetin tip “Mercedes Benz 250 D”, viti i prodhimit 1992, me targa *, blerë dhe regjistruar në qershor të vitit 2004. Vlera: 530.000 lekë. Burimi i krijimit:**

- b. të ardhura familjare nga puna;
- c. shitje pasurie sipas kontratës nr. ***, datë 28.3.2004.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁵⁹.

5.1 ILDKPKI-ja është shprehur në raport: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjet e DPSHTRr-së.

Faktet e konstatuara nga hetimi administrativ i Komisionit

5.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2004 me përshkrimin “blerë një automjet tip ‘Mercedes Benz 250 D’, prodhim i vitit 1992, e përdorur”. Vlera: 530.000 lekë.

5.3 DPSHTRr-ja me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2019 informon se nga verifikimet e bëra në sistemin informatik rezultoi se:

- Z. Ardit Mustafaj ka të regjistruar mjetet me targa ***, *** dhe ***.

5.4 Mjeti me targa *** (aktualisht me targa ***) është shitur, konfirmuar me kontratën e shitjes nr. ***, datë 16.5.2017.

5.5 Sipas dokumentacionit mbështetës, mjeti është zhdoganuar me deklaratën doganore nr. ***, datë 27.6.2004, në shumën 193.519 lekë, e cila është paguar nga z. Ardit Mustafaj, konfirmuar me urdhërderdhjen e Bankës së Kursimeve nr. ***, ku urdhërues është po subjekti i rivlerësimit.

⁵⁹Certifikatë pronësie për automjetin tip “Mercedes Benz”, me targa ***, shkresë nr. ***, datë 18.10.2016, nga DPSHTRr-ja Tiranë, bashkëlidhur praktika; deklaratë doganore: monedha e faturuar 300.000 lekë; shpenzimet doganore 193.519 lekë për automjetin tip “Mercedes Benz”, automjet i ardhur nga Stuttgart, Gjermani (aneksi nr. 4/6, në dosjen e ILDKPKI-së).

5.5.i Në deklaratën doganore çmimi i blerjes pasqyrohet në vlerën 300.000 lekë, ku mbi këtë shumë janë kryer përlllogaritjet për zhdoganimin e mjetit, si dhe shpenzimet e transportit në vlerën 19.787 lekë.

5.5.ii Nga deklarata doganore kuptojmë që totali i shpenzuar për blerjen e automjetit është 513.306 lekë.

5.6 Komisioni nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare të të gjithë vitit 2004, pasi shitja e pasurisë sipas kontratës nr. ***, datë 28.3.2004 për objektin 1+1 kate është përdorur si burim krijimi për këtë automjet, si dhe për pasurinë nr.1, po në vitin 2004 dhe për pasojë është e pamundur të ndahet shuma e përdorur për këtë pasuri apo për tjetrën. Nga analiza financiare për vitin 2004, trupit gjykues i ka rezultuar se:

✓ Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të të ardhurave në shumën 2.700.033 lekë, në vitin 2004, për të investuar në këtë pasuri të luajtshme, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

6. Në lidhje me automjetin tip “Daewoo Matiz 0.8”, vit prodhimi 2001, me targa *, blerë në datën 30.11.2013, regjistruar në datën 12.12.2013. Vlera: 160.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura familjare nga puna.**

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶⁰.

6.1 ILDKPKI-ja është shprehur në raport: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjet e DPSHTRr-së.

Faktet e konstatuara nga hetimi administrativ i Komisionit

6.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2013 me përshkrimin “blerje automjeti tip ‘Daewoo Matiz 0.8’ benzinë, vit prodhimi 2001, me kursimet familjare nga të ardhurat nga puna”. Vlera: 160.000 lekë (ku përfshihet çmimi i blerjes 70.000 lekë, taksat doganore, regjistrimi).

6.3 Kjo pasuri konfirmohet me kontratë⁶¹ shitblerjeje (pasuri e luajtshme-automjet) nr. ***, datë 30.11.2013, me palë shitëse shtetasin Gj. U. dhe palë blerëse shtetasit S. dhe Ardit Mustafaj. Çmimi i shitjes: 70.000 lekë.

6.4 DPSHTRr-ja me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2019 informon se nga verifikimet e bëra në sistemin informatik rezultoi se:

- Znj. S. M. ka të regjistruar mjetin me targa ***

6.5 Rezultoi se mjeti është zhdoganuar me deklaratën doganore nr. ***, në vlerën 24.197 lekë (pas rivlerësimit të kryer nga dogana). Vlera e investuar është në një shumë të vogël në krahasim me të ardhurat e subjektit, por, Komisioni përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën e gjithë vitit 2013 mbi mundësinë financiare të subjektit në këtë vit nga ku ka rezultuar se:

✓ Subjekti ka pasur mundësi financiare për të investuar në blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare përgjatë vitit 2013.

7. Në lidhje me depozita kursimi në “Banka Kombëtare Tregtare”, Tiranë. Vlera: 2.193.174 lekë. Burimi i deklaruar i krijimit: të ardhura familjare nga puna dhe nga qiraja.

⁶⁰Kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 30.11.2013, për automjetin tip “Daewoo”, në vlerën 70.000 lekë, blerës znj. S. M.; certifikatë pronësie për automjetin me targa *** (aneksi nr. 4/7, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶¹Aneks 4/7, në dosjen e ILDKPKI-së.

7.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës⁶² vërtetimin nr. ***, datë 19.1.2017, nga “Banka Kombëtare Tregtare”, ku vërtetohet se z. Ardit Mustafaj ka depozitë me gjendje në vlerën 2.193.174 lekë.

7.2 ILDKPKI-ja është shprehur në raport: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjet e BKT-së dhe DPPPP-së.

7.3 Komisioni hetoi mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja e garazhit me sip.18.31 m² në Tiranë. Nga korrespondenca e mbajtur me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë⁶³ konfirmohet pagesa e tatimit në burim për kontratën e qirasë. Nga korrespondenca e mbajtur, BKT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 7.1.2020 konfirmon depozitë në emër të subjektit Ardit Mustafaj, në shumën 2.193.012,07 lekë, në datën 31.12.2016.

✓ Në kushte të tilla, trupi gjykues konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi shumën e zotëruar në bankë, si dhe provohet me dokumentacion justifikues ligjor burimi i ligjshëm i krijimit.

8. Në lidhje me kursime familjare të vitit 2016 (në datën 31.12.2016). Shuma 540.000 lekë, të cilat aktualisht ndodhen në:

- 1- depozitë kursimi në “Raiffeisen Bank”;
- 2- gjendje në llogarinë e pagave në bankë;
- 3- gjendje *cash*.

Burimi i deklaruar i krijimit: të ardhura familjare nga puna dhe nga qiraja.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶⁴.

8.2 ILDKPKI-ja është shprehur në raport: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

8.3 Nga korrespondenca e mbajtur, “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2019 konfirmon:

- llogari page në emër të subjektit me gjendje në datën 31.12.2016, në vlerën 97.150 lekë;
- depozitë në emër të subjektit me gjendje në datën 31.12.2016, në vlerën 330.000 lekë;
- llogari page në emër të bashkëshortes me gjendje në datën 31.12.2016, në vlerën 25.355 lekë.

8.3.i Totali në bankë ka rezultuar në vlerën 452.505 lekë.

8.3.ii Rezulton se diferenca prej 87.495 lekësh është gjendje *cash*.

✓ Në analizë të dokumentacionit të administruar, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi kursimet familjare për vitin 2016.

⁶²Shihni aneksin nr. 4/8, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶³Shkresë nr. *** prot., datë 20.5.2019, nga DRT-ja Tiranë.

⁶⁴Kontratë depozitë me afat datë 25.10.2016, në “Raiffeisen Bank”; nxjerrje llogarie page në datat 3.9.2013 dhe 24.1.2017, për periudhën 8.1.2010 – 24.1.2017, me gjendje në datën 24.1.2017, në vlerën 158.234 lekë në “Raiffeisen Bank”; nxjerrje llogarie page në emër të znj. S. M. për periudhën 7.1.2010 – 20.1.2017, me gjendje në vlerën 68 lekë nga “Raiffeisen Bank” (aneksi nr. 4/9, në dosjen e ILDKPKI-së).

9. Në lidhje me kursime familjare në janar të vitit 2017. Aktualisht, në llogarinë e pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank”, ndodhet e pa tërhequr vlera 61.200 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶⁵. Burimi i krijimit: të ardhura familjare nga puna.

9.1 ILDKPKI-ja është shprehur në raport: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

9.2 Nga korrespondenca e mbajtur, “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2019, konfirmon llogari page në emrin e subjektit. Diferenca midis pagës së marrë në janar të vitit 2017 (135.220 lekë), tërheqjeve dhe pagesave të kryera deri në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” (74.010 lekë), rezulton e kursyer në shumën 61.200 lekë.

✓ Trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

10. Në lidhje me llogarinë në emër të vajzës, *, në “Credins Bank” (gjendje aktuale).** Vlera: 18.000 lekë. Burimi i deklaruar i krijimit: shpërblim nga Bashkia Tiranë për arritje në mësim.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga “Credins Bank”, datë 20.1.2017, në emrin e vajzës Arsi Mustafaj, me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën 18.000 lekë.

10.1 ILDKPKI-ja është shprehur në raport: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e “Credins Bank”.

10.2 Nga korrespondenca e mbajtur, “Credins Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 28.6.2019, konfirmon llogarinë në emër të vajzës së subjektit, ***, me gjendje në vlerën 18.000 lekë, datë 10.1.2017.

✓ Trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Credins Bank”.

11. Detyrime financiare

Kredi për strehim në shumën 5.000.000 lekë, të marrë në datën 18.10.2006, me afat 25 vjet, me interes 3 %, kësti mujor në shumën 23.710,57 lekë në muaj, në “Raiffeisen Bank”. Përfundon në datën 18.10.2031 kontrata e kredisë dhe e hipotekës nr. ***, datë 27.9.2006. Shuma e detyrimit financiar 3.387.924,49 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶⁶.

Nga korrespondenca e mbajtur dhe dokumentacioni i administruar, “Raiffeisen Bank” me shkresën nr.*** prot., datë 7.5.2019 konfirmon kredinë e marrë nga subjekti dhe detyrimi i mbetur deri në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting” është në shumën 3.387.924,49 lekë.

✓ Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

⁶⁵Kontratë depozitë me afat datë 25.10.2016, në “Raiffeisen Bank”; nxjerrje llogarie page në datat 3.9.2013 dhe 24.1.2017, për periudhën 8.1.2010 – 24.1.2017, me gjendje në datën 24.1.2017, në vlerën 158.234 lekë, në “Raiffeisen Bank”; nxjerrje llogarie page në emër të znj. S. M., për periudhën 7.1.2010 – 20.1.2017, me gjendje në vlerën 68 lekë nga “Raiffeisen Bank” (aneksi nr. 4/9, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶⁶Vërtetim nr. ***, datë 24.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”; kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr. ***, datë 27.9.2006, të ap. me sip. 65 m², Sarandë, të ap. me sip. 54 m², Sarandë, + praktika e kontratës; nxjerrje llogarie rrjedhëse në emër të subjektit Ardit Mustafaj, për pagesat e kësteve të kredisë në “Raiffeisen Bank” (aneksi nr. 4/12, në dosjen e ILDKPKI-së).

12. Deklarimi i pasurisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit

12.1 Pasuri e llojit truall, me sip. 1.000 m², në vlerën 320.000 lekë në fshatin Sh., Delvinë, dhënë për shesh ndërtimi nga Këshilli i Komunës Finiq, me vendimin nr. 146, datë 19.3.2003. Burimi i deklaruar i krijimit: të ardhura familjare nga puna dhe hua (e kthyer plotësisht). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶⁷.

12.1.i ILDKPKI-ja është shprehur në raport: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur, ZVRPP-ja Sarandë nuk e konfirmon, pasi subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me këtë pronë.

Faktet e konstatuara nga hetimi administrativ i Komisionit

12.1.ii Subjekti e deklaroi për herë të parë pasurinë në deklaratën periodike të vitit 2005. Vlera e truallit është 320.000 lekë, e paguar në datën 6.11.2003 në Bankën e Kursimeve.

12.1.iii Kjo pasuri konfirmohet me kontratë⁶⁸ shitjeje datë 10.11.2003, lidhur midis përfaqësuesit të seksionit të financës z. J. M., dhe blerësit znj. S. M. për blerjen e truallit të ndërtimit me sip.1.000 m² me çmim 320 lekë/m², veprim i kryer sipas kësaj kontrate, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 312, datë 30.6.1994. Qëllimi i përdorimit të truallit, gjithnjë, sipas të dhënave të kontratës është: magazinë me shumicë. Shitja rezultoi të jetë bërë në bazë të Vendimit të Këshillit të Komunës nr. 146, datë 19.3.2003. Në deklaratën “Vetting”, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në rubrikën “të dhëna konfidenciale” se për këtë truall është paguar vlera prej 320 000 lekësh, por se nuk është lidhur kontratë noteriale për blerjen e truallit, nuk është nxjerrë ndonjë leje ndërtimi, nuk është kryer ndërtim, as prej saj apo as prej bashkëshortit nuk është kryer ndonjë veprim faktik mbi këtë truall për shkak të pamundësisë financiare, citon se nuk ka fituar të drejta reale dhe as pronësi mbi këtë truall dhe se ky truall nuk është regjistruar në ZVRPP. Po ashtu, në vijim, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se për shkak të fitimeve të mundshme të pronësisë gjatë periudhës 14-vjeçare nga ish-pronarë të mundshëm, aktualisht për të, statusi juridik i sipërfaqes së tokës është i paqartë dhe po ashtu, nëse vendimi nr. 146, datë 19.3.2003 është ende në fuqi.

12.1.iv Për këtë pasuri, Bashkia Finiq⁶⁹ ka depozituar dokumentacionin përkatës, ku ndër të tjera, citon se nuk është në dijeni se zona që është akorduar parcela ndërtimore ka pasur konflikte apo kërkesa nga subjekte të tjera për pretendim prone dhe se zyrtarisht nuk është njoftuar për procese gjyqësore.

12.1.v Për sa më sipër, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës⁷⁰ për të dhënë shpjegime se përse për të, statusi juridik i kësaj pasurie është i paqartë, për sa kohë palët nuk ishin kthyer në gjendjen e mëparshme, si dhe iu kërkua të depozitojë dokumentacion që provonte se kjo pasuri nuk është regjistruar në ZVRPP.

⁶⁷Kontratë shitjeje, datë 10.11.2003, midis seksionit të financës dhe znj. S. M., të sip. truall 1.000 m², ndodhur në Delvinë, Sarandë, në vlerën 320.000 lekë; vendim për dhënie shesh ndërtimi nr. ***, datë 19.3.2003, lëshuar nga Komuna Finiq, për ndërtimin e kateve mbi tokë 1 + 1 (aneksi nr. 4/18).

⁶⁸Aneks 4/18, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁹Shkresë nr. *** prot., datë 6.2.2020, në dosjen e Komisionit.

⁷⁰Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

12.1.vi Në parashtrime, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka sqaruar se bashkëshortja deri më sot nuk ka kryer asnjë ndërtim dhe asnjë lloj veprimi tjetër në këtë truall.

12.1.vii Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se nuk është kërkuar dhe as nuk është nxjerrë ndonjë leje ndërtimi dhe se për këto arsye nuk është proceduar as me lidhjen e kontratës noteriale të shitblerjes së truallit.

12.1.viii Po ashtu, subjekti ka qartësuar se duke qenë se bashkëshortja nuk e ka fituar pronësinë që nga viti 2003 dhe deri në vitin 2016 kur është bërë deklarimi për rivlerësimin, teorikisht nuk ka përjashtuar mundësinë që gjatë kësaj periudhe ish-pronarë të mundshëm të kenë pretenduar dhe fituar pronësinë në zonën ku ndodhet trualli. Subjekti ka konfirmuar se nuk ka informacion konkret për këtë, por bashkëshortja është nisur nga fakti se legjislacioni lidhur me kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve, legjislacioni lidhur me privatizimin e pronave shtetërore, si dhe interpretimet gjyqësore të Gjykatës së Lartë, u kanë dhënë përparësi ish-pronarëve për kthimin e tokës në rastet kur janë të pazëna me ndërtime, siç është rasti konkret.

12.1.ix Subjekti, në parashtrime, i është referuar edhe nenit 46, të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” (siç ka qenë në fuqi në vitin 2003) ku parashikohet se Këshilli i Komunës/Bashkisë ka të drejtë të rishpërndajë sheshin e ndërtimit në rast se brenda tre muajve nga miratimi i destinacionit të funksionit dhe të kushteve urbanistike të sheshit të ndërtimit nuk është paraqitur kërkesa për leje ndërtimi. Subjekti është shprehur se në kushtet kur nuk është paraqitur ndonjëherë kërkesë për leje ndërtimi dhe nuk kanë pasur as informacion për vendimmarrje të mundshme të Këshillit të Komunës/Bashkisë Finiq për rishpërndarje të sheshit të ndërtimit, teorikisht në deklarin për rivlerësim janë mbajtur parasysht raste të kësaj natyre.

12.1.x Situata e mësipërme (është shprehur subjekti) ka ardhur për shkak të mosinteresimit të bashkëshortes për sipërfaqen e truallit që prej vitit 2003, e lidhur kjo edhe me situatën e bllokuar dhe të paqartë nga pikëpamja ligjore të këtyre lloj sipërfaqeve. Pikërisht, për këtë arsye të fundit Këshilli i Ministrave ka miratuar së fundmi Vendimin nr. 329, datë 22.5.2019, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, me të cilin ka hapur rrugën e regjistrimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme të këtyre sipërfaqeve të dhëna si sheshe ndërtimi, pa pasur nevojë për të kryer më parë ndërtim mbi to.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

12.1.xi Trupi gjykues, në analizë të fakteve të dala dhe të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë nga subjekti nuk u provua kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme dhe për pasojë as edhe kthimi i shumës së investuar për blerjen e truallit me sip. 1000 m² dhe po ashtu, për sa kohë pala shitëse nuk e ka ushtruar të drejtën që zotëron, të parashikuar sipas nenit 46, të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” (siç ka qenë në fuqi në vitin 2003) për të rishpërndarë sheshin e ndërtimit (megjithëse subjekti nuk kishte paraqitur brenda tre muajve kërkesë për leje), konkludon se kontrata e shitjes së truallit nga seksioni i financës në Bashkinë Finiq në favor të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit është në fuqi. Në këto kushte, trupi gjykues:

- ✓ Në konsideratë të parashikimeve ligjore, konkretisht, Vendimit nr. 329, datë 22.5.2019, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë

Shtetërore të Kadastrës”, si dhe për shkak se nga hetimi nuk u konstatuan fakte ndryshe, çmon se subjekti ka kryer deklaram të saktë për këtë pasuri.

II. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, përmes verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës, me nr. ***, datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar:

Nga hetimi nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, **DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj.**

Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kontrollin e kriterit të figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta as edhe nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti mbi këtë vlerësim është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në: formularin e vetëdeklarimit; tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- a) Aftësitë profesionale
- b) Aftësitë organizative
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale
- ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Raporti pas analizimit të tetë dokumenteve ligjore, të llojit vendime dhe dosje gjyqësore, në vlerësim të tyre është shprehur lidhur me analizën e gjetjeve, si vijon:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit në rastin konkret. Ka njohuri për analizën e veprës penale lidhur me fajësinë e autorëve të akuzuar dhe për shqyrtimin e kërkesave administrative penale.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara nga subjekti janë të qarta dhe të kuptueshme. Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Subjekti ka proceduar duke nxjerrë vendime të ndërmjetme dhe duke treguar shkakun ligjor.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Ardit Mustafaj. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nisur nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj. Për gjyqtarin Ardit Mustafaj, në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtim nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

RIVLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLGJ-së, sipas shkresës nr. *** prot., datë 30.9.2019;
- vlerësimit të denoncimeve të paraqitura në ankesat e subjekteve denoncuese;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Në lidhje me analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisionit, sikurse edhe Grupit të Punës në raportin e vlerësimit, në tërësi nuk i kanë rezultuar problematika në lidhje me shqyrtimin dhe gjykimin e çështjeve gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit në të tria dokumentet/vendimet gjyqësore dhe në pesë dosjet e shortuara, ndërsa më në detaje i ka rezultuar, si vijon:

- i. Vendimet janë të strukturuar në paragrafë. Në arsyetimin e vendimeve përmenden dhe analizohen norma të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale.
- ii. Subjekti, në arsyetimin e vendimeve, ka përdorur parime e norma legjislative.
- iii. Në pesë dosjet e vëzhguara, palët ndërgjyqëse kanë paraqitur ankim⁷¹ kundër vendimit të subjektit në tri raste dhe në dy nga këto tri raste, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka vendosur lënien në fuqi, ndërsa për rastin e tretë e ka ndryshuar vendimin vetëm sa i përket masës së dënimit, duke e zbutur atë. Për dy dosjet e tjera nuk është ushtruar ankim nga palët.
- iv. Dosjet penale janë gjykuar dhe përfunduar brenda afatit standard 12 muaj të gjykimit të përcaktuar nga germa “f”, e pikës 5, të vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” dhe në përputhje me standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42, të Kushtetutës dhe nenit 6, të KEDNJ-së.
- v. Në tërësi, dosjet së bashku me vendimin e zbardhur rezultojnë të jenë depozituar në sekretarinë e gjykatës brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113, i Kodit të Procedurës Penale.
- vi. Seancat janë caktuar brenda afatit të përcaktuar në nenet 333/1, 333/2 dhe 342/2 të Kodit të Procedurës Penale.
- vii. Procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje përmbajnë të gjitha përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, konform kërkesave të nenit 346, të Kodit të Procedurës Penale.
- viii. Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 383, të Kodit të Procedurës Penale, i cili është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Gjyqtari i është referuar praktikës gjyqësore e konkretisht vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 1, datë 25.3.2005 dhe vendimin nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese.
- ix. Në përgjithësi është proceduar me gjykim të shkurtuar (në gjendjen në të cilën ndodhen aktet në dosje).
- x. Gjuha e përdorur në aktet e dosjes rezulton në përputhje me etikën gjyqësore, nuk ka elemente që lidhen me paanësinë e subjektit, nuk ka të dhëna në dosje nëse ka pasur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit.

Komisionit, sikurse është shprehur edhe KLGJ-ja nuk i kanë rezultuar problematika lidhur me vlerësimin e subjektit të rivlerësimit sa i përket etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, integritetit, paanësisë dhe aftësive personale dhe angazhimit profesional.

➤ **Mbi denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit**

Në lidhje me dy⁷² denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, Komisionit i ka rezultuar, si vijon:

⁷¹Shih dosjet 1, 2 dhe 5.

⁷²Nr. *** prot., datë 12.12.2017 dhe nr. *** prot., datë 13.6.2018, në dosjen e hetimit administrativ.

1. Denoncimi⁷³ i shtetasesh. O. I.

Në parashtrime, denoncuesja pretendon për dënim të padrejtë, dhënë nga subjekti i rivlerësimit ndaj të pandehurit, i cili ka qenë vrasësi i vëllait të saj. Nga aktet e depozituara nga denoncuesja, rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 18.7.2017, ka dënuar të pandehurin, z. I. A., për veprën penale të “vrasjes për gjakmarrje” me 35 vjet burgim dhe se ky vendim, ku me cilësinë e kryesuesit të seancës ka qenë subjekti i rivlerësimit, ka marrë formë të prerë në datën 31.7.2017. Nga përlllogaritjet e bëra midis datës së dhënies së vendimit dhe marrjes formë të prerë, lehtësisht kuptohet se ndaj subjektit nuk është ushtruar ankim, si një e drejtë legjitime që në këtë rast ka qenë për t’u ushtruar edhe nga denoncuesja në organin gjyqësor.

- ✓ Në të tilla kushte, trupi gjykues çmon se denoncimi nuk përbën fakte dhe rrethana që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

2. Denoncimi⁷⁴ i shtetasit A. R. Z.

Denoncuesi në parashtrime ankohet për shkelje të etikës profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe për këtë ka paraqitur vendimin nr. ***, datë 11.5.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, në të cilin rezulton me cilësinë e anëtarit. Nga verifikimi i vendimit rezulton se i pandehuri, z. A. Z., i akuzuar për veprën penale të “korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë” në bashkëpunim, bazuar në nenet 260 dhe 25 të Kodit Penal, është dënuar me pesë vjet burgim, sikurse është kërkuar edhe nga përfaqësuesi i organit të prokurorisë në konkluzionet përfundimtare. Megjithatë nuk janë depozituar akte të tjera në mbështetje të denoncimit për t’u kuptuar nëse është ushtruar ankim ndaj subjektit dhe se si ka vijuar më tej zhvillimi i procesit gjyqësor, trupi gjykues në analizë të pretendimeve të subjektit për shkelje të etikës pa sqaruar asnjë rrethanë tjetër dhe vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit, konkludon se:

- ✓ Pretendimi i denoncuesit mbetet i paprovuar dhe se nuk përmban fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se informacionet e denoncuesve në tërësi nuk provohen dhe për pasojë nuk ndikojnë në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016.

Nga shqyrtimi i parashtrimeve në denoncime, si dhe nga dokumentacioni i administruar u vërejt se nuk kanë rezultuar shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

Për të gjitha shkaqet dhe arsyet e sipërpërmendura, trupi gjykues, pas rivlerësimit të raportit të Grupit të Punës, fakteve publike, denoncimeve, nuk gjeti *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale dhe pas rekomandimit të relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas gremës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

⁷³Nr. *** prot., datë 12.12.2017, në dosjen e hetimit administrativ.

⁷⁴Nr. *** prot., datë 13.6.2018.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se:

- Lidhur me kontrollin e pasurisë nën hetimin e thelluar, subjekti i rivlerësimit:

a) për pasurinë e identifikuar me nr. 1, nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të huas së marrë në shumën 2.000.000 lekë, shtetasit A. M., burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 850.000 lekë, krijuar nga mësimdhënia e kurseve jashtëshkollore nga bashkëshortja e subjektit, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këto të ardhura të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie, si dhe bazuar në analizën financiare, rezultoi se ka mungesë të të ardhurave, në shumën 2.700.033 lekë, në vitin 2004, për të investuar në këtë pasuri të paluajtshme, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

b) për ndërtimin e objektit 1+1 në Sarandë, në vitin 2003, bazuar në rillogaritjet e bëra në analizën financiare, rezultoi se ka mungesë të të ardhurave në shumën 6.686.074 lekë, për të kryer të gjitha investimet gjatë vitit 1996 deri në vitin 2003, për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, si dhe nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë me dokumentacion justifikues vlerën e shpenzuar për ndërtimin e objektit dhe për pasojë ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e kësaj pasurie, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

c) për pasurinë e identifikuar me nr. 4, nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues burimin e ligjshëm të shumës 1.700.000 lekë, marrë hua nga shtetasi Gj. D., sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në rillogaritjet e bëra në analizën financiare për vitin 2003, ka mungesë të të ardhurave për të justifikuar pagesën e shumës 22.000 USD për këtë pasuri në vitin 2003, deklaruar në deklaratën “Vetting”.

d) për pasurinë e identifikuar me nr. 5, rezultoi se ka mungesë të të ardhurave, në shumën 2.700.033 lekë, në vitin 2004, për të investuar në këtë pasuri të luajtshme, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

- Për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues, në konsideratë të verifikimit e konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmëri në detyrë edhe pas hetimit të Komisionit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Për kontrollin profesional, trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës (neni E), ligjit nr. 84/2016 (kreu VI), vlerëson se subjekti ka përmbushur kushtet ligjore të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në pikën 3, të nenit 61, në germën “c”, pikën 1, të nenit 58, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ardit Mustafaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 5.3.2020.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Firdes Shuli

Kryesuese

Brunilda Bekteshi

Relatore

Olsi Komici

Anëtar

Sekretare gjyqësore

Denisa Kosta